




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Raporti Vjetor i Monitorimit

Menaxhimi i Financave Publike

2023



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i monitorimit

Ky raport vjetor i monitorimit për zbatimin e Reformave të Menaxhimit të Financave Publike mbulon periudhën nga 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023. Ai përshkruan ecurinë e aktiviteteve dhe arritjeve të planifikuara të reformave kundrejt treguesve të performancës dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë e re sektoriale të MFP-së për 2023-2030 dhe planin e veprimit për 2023-2026. Hartuar gjatë vitit 2023, strategjia sektoriale e MFP-së përputhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, Udhërrëfyesin e RAP-it, Programin e Reformave Ekonomike dhe axhendën më të gjerë të Integritimit Evropian. Strategjia dhe plani i veprimit u miratuan zyrtarisht pas kësaj periudhe raportuese përmes VKM nr. 390, datë 12 qershor 2024, “Për Miratimin e Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030”.

Strategjitë nën sektoriale

Gjatë periudhës raportuese, plani i veprimit të MFP-së u zbatua krahas disa strategjive nën sektoriale, duke përfshirë draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore të Shqipërisë, Strategjinë e Prokurimit, Strategjinë e Menaxhimit të Borxhit dhe Strategjinë e Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH).


Bashkëpunimi me partnerët e zhvillimit

Qeveria mbajti bashkëpunim produktiv me partnerët e zhvillimit për zbatimin e strategjisë. Kjo përfshinte vlerësime të rregullta për të vlerësuar gjendjen e politikave dhe sistemeve të MFP-së, të tilla si konsultimet nën Nenin 4 të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe përgatitjen e një Vlerësimi të Shpenzimeve Publike dhe Kontabilitetit Financiar me BE-në, së bashku me vlerësimin e Parimeve të Administratës Publike me SIGMA. Të dy vlerësimet janë vendosur të zbatohen në vitin 2024. Projekte të shumta asistence teknike dhe mbështetje të financuara nga partnerët e zhvillimit vazhdojnë të përmirësojnë sistemet e MFP-së, me partnerë kryesorë duke përfshirë FMN-në, Bankën Botërore, BE-në, SIGMA dhe SECO.


Ecuria e përgjithshme

Plani i veprimit të MFP për vitin 2023 përfshin 30 tregues të performancës dhe 46 aktivitete në gjashtë shtylla. **Zbatimi i planit të veprimit është në rrugën e duhur**, ku të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin 2023 janë të përfunduara ose duke përparuar sipas parashikimeve, dhe shumica e objektivave të treguesve të performancës të arritur, siç tregohet në grafikët e mëposhtëm.

Grafiku 1: Statusi i objektivave të treguesve të performancës



Grafiku 2: Statusi i aktiviteteve



Pikat kryesore të shtyllave

Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut

Ministria e Financave (MF) ka ruajtur dhe përmirësuar sistemet për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të shëndosha fiskale, të udhëhequra nga rregullat fiskale, parashikime të forta makroekonomike dhe menaxhim solid të risqeve fiskale. Pajtueshmëria me rregullat fiskale është raportuar në mënyrë transparente në dokumentet kyçe, duke përfshirë “Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal”, “Programin e Reformave Ekonomike” dhe “Raportin për Zbatimin e Buxhetit Vjetor”, Situatës Makroekonomike dhe Fiskale'. Veçanërisht, Ministria përgatiti në 2023 Deklaratën e parë të Risqeve Fiskale (DRF) për vitin 2022 në bazë pilotimi. Drafti i parë shërbeu si një dokument pilot për përdorim të brendshëm në MF, prandaj nuk u publikua. Ai ishte gjithashtu një dokument referimi i përdorur në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë (FMN) për përpilimin e dokumentit të ardhshëm zyrtar në vitin 2024, DRF 2023. Megjithatë, mbetet një sfidë rekrutimi i stafit makroekonomik shumë të kualifikuar. Hendeqet me rekrutimet e reja do të plotësohen në periudhën afatmesme, ndërsa për stafin ekzistues janë thelbësore trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve.

Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent

Është përmirësuar ndjeshëm pajtueshmëria e dokumenteve të reja strategjike me Udhëzimet e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Me miratimin e VKM nr. 887/2022, ka hyrë në fuqi një rregullore e rishikuar për Menaxhimin e Investimeve Publike (MIP). U prezantuan udhëzime shtesë për vlerësimin e rëndësisë strategjike të projekteve të investimeve publike dhe renditjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Aktivitete të ndryshme trajnimi u kryen për të siguruar zbatimin efektiv të udhëzimeve të reja MIP. Një Sistem i ri i Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) u zhvillua dhe u miratua për të përmirësuar përgatitjen dhe monitorimin e buxhetit në nivel nën kombëtar, që është caktuar për të filluar në T1 2024. Janë prezantuar procedura të reja për monitorimin e zbatimit të projekteve të investimeve publike.

Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave

Janë zbatuar disa masa të draft Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2022-2026.

Me ofrimin e trajnimeve të stafit, janë rritur gradualisht kapacitetet institucionale për të analizuar dhe zhvilluar politikatat tatimore dhe për të menaxhuar reformat tatimore.

Konsolidimi i sistemit të fiskalizimit dhe përmirësimi i qasjeve të menaxhimit të riskut kanë mbështetur reduktimin e hendekut të pajtueshmërisë me TVSH-në. Për më tepër, legjislacioni i amenduar tanimë i mundëson Administratës Tatimore të adresojë më mirë pasurinë e pajustificuar. Hartimi i një strategjie për ofrimin e shërbimit të tatimpaguesve së bashku me vazhdimin e trajnimit të stafit synon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për tatimpaguesit. Në vitin 2023 u hartua një ligj i ri për taksën e pasurisë së paluajtshme dhe iu nënshtrua procesit të konsultimit publik si pjesë e nismës në vazhdim të reformës së taksës së pasurisë, që pritet të përfundohet në vitin 2030. Menaxhimi i doganave është përmirësuar gjithashtu në përputhje me strategjinë e biznesit të administratës doganore shqiptare. Koha e përpunimit të deklaratave doganore është zvogëluar dhe numri i aplikimeve të suksesshme nga operatorët ekonomikë ka vazhduar të rritet. Shfrytëzimi i kanalit të gjelbër është 28% për vitin 2023. Administrata Doganore Shqiptare (ADSh) ka vazhduar të modernizojë proceset e saj të biznesit dhe menaxhimit të riskut nëpërmjet trajnimit të stafit, investimeve në sistemet informative (si Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave), zhvillimit të një kuadri të integritetit, dhe përpjekjet për të luftuar informalitetin dhe korrupsionin. Gjithashtu, ka pasur një rritje të numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (OEA) dhe ecuri në zhvillimin e Dritares së Vetme Kombëtare.

Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit

Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar Shqiptar (SIMFSH) mbetet sistemi informativ kryesor i qeverisë për menaxhimin financiar. Institucione të shumta buxhetore kanë marrë akses në sistem, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet Arkivit Elektronik (Portali Web). Faza e dytë e reformave të kontabilitetit është duke vijuar me hartimin e një koncept dokumenti për hartimin e kuadrit ligjor dhe sigurimin e mbështetjes nga donatorët, ndërkohë që vazhdon trajnimi për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për kontabilistët e sektorit publik. Janë përgatitur ndryshime në kuadrin rregullator të Prokurimit Publik dhe në veçanti VKM 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ka përparuar zbatimi i Prokurimit Publik të Gjelbër me përgatitjen e udhëzuesit dhe metodologjisë për prokurimin publik të gjelbër dhe ofrimi i trajnimeve për profesionistët e prokurimeve. Ministria e Financave ka publikuar Planin Vjetor të Huamarrjes 2024 dhe Raportin e Strategjisë së Menaxhimit të Borxhit 2022. Për përmirësimin e menaxhimit të aseteve, janë ndërmarrë hapa për të krijuar kuadrin e duhur rregullator në lidhje me vlerësimin dhe inventarizimin e aseteve publike dhe për përgatitjen e një regjistri të konsoliduar të aseteve në institucionet qendrore.

Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

Në vitin 2023 u bënë ndryshime në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), të shoqëruar me përditësime të manualit të MFK-së dhe udhëzime të ndryshme. Ministria e Financave ka mbështetur institucionet publike në rritjen e llogaridhënies manaxheriale dhe menaxhimit të risqeve, që ka rezultuar në rritjen e përputhshmërisë me kërkesat e MFK-së. Pas ndryshimit të ligjit për auditimin e brendshëm, është bërë përparim i dukshëm në zhvillimin e mjeteve dhe mekanizmave për kontraktimin nga jashtë të shërbimeve të auditimit të brendshëm. Ministria e Financave vazhdoi të mbështesë profesionalizimin e praktikave kryesore të auditimit të brendshëm përmes zhvillimit të udhëzimeve dhe ofrimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve. Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit kanë ndërmarrë hapat e parë për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Kjo strategji pritet të përfundohet dhe miratohet në vitin 2024. Për sa i përket menaxhimit të fondeve të BE-së, të gjitha paketat e besimit të IPA III për Programet Vjetore të Veprimit IPA 2022 dhe tre Programe Operacionale janë përgatitur dhe dorëzuar zyrtarisht në KE. Krijimi i kuadrit ligjor IPA III ka përfunduar me miratimin e VKM nr. 540/2023. Kjo u pasua me aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve të strukturave IPA III.

Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtme

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me strategjinë e tij të zhvillimit, vazhdoi të përmirësojë më tej kontrollin efektiv të institucioneve publike, duke zgjeruar mbulimin dhe standardet e auditimit për të siguruar mbikëqyrjen e plotë të proceseve financiare dhe për të forcuar praktikën e ndjekjes së auditimit të jashtëm, thelbësore për ruajtjen e llogaridhënies dhe transparencës në praktikën e menaxhimit financiar. Në të njëjtën kohë, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat po përparon në mënyrë aktive drejt përmirësimit të shqyrtimit legjislativ të raporteve të auditimit me mbështetjen e disa partnerëve të zhvillimit.

Menaxhimi i riskut

Risqe të shumta janë materializuar ose janë identifikuar, që ndikojnë negativisht në zbatimin e planit të veprimit. Këto përfshijnë numrin e pamjaftueshëm të burimeve njerëzore të kualifikuara, kapacitetin e ulët të burimeve njerëzore ekzistuese dhe lëvizjen e stafit, kufizimet në burimet buxhetore të disponueshme për zbatimin e aktiviteteve të reformave, mungesën e bashkërendimit dhe angazhimit të palëve të interesit, vonesat në prokurim dhe vonesat në hartimin dhe miratimin e ndryshimeve ligjore. Masat e marra dhe të planifikuara për t'iu përgjigjur këtyre risqeve janë zhvillimi dhe zbatimi i planeve të rekrutimit dhe trajnimit, përmirësimi i bashkërendimit dhe komunikimit me partnerët dhe palët e interesit, monitorimi i ngushtë i procedurave për prokurimin dhe ndryshimet ligjore.

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË 2023-2030	7
1.1 HYRJE.....	7
1.2 METODOLOGJIA E MONITORIMIT	7
1.3 VIZIBILITETI DHE KONSULTIMET E MFP-SË	8
2. ECURIA E STRATEGJISË NË 2023	9
2.1 ARRITJET NË ZBATIMIN E SHTYLLAVE TË STRATEGJISË MFP PËR 2023	9
2.2 NDIKIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË MFP-SË NË PËRPUTHJE ME AXHENDËN E INTEGRIMIT EVROPIAN	10
2.3 NDIKIMI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT NË RAJON DHE/OSE MË GJERË	12
2.4 AKTIVITETET E SHTYLLAVE QË NUK PËRPARUAN SIPAS PLANIT	12
2.5 ZBATIMI I BUXHETIT TË PËRGJITHSHËM	13
3. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE TË STRATEGJISË SË MFP	15
3.1 PROGRESI NË SHTYLLËN 1 “PROGRAMIMI MAKROEKONOMIK DHE MONITORIMI I RISKUT”	15
3.2 PROGRESI NË SHTYLLËN 2 “PLANIFIKIMI I INTEGRUAR STRATEGJIK DHE BUXHETOR, MONITORIMI DHE RAPORTIMI TRANSPARENT”	17
3.3 PROGRESI NË SHTYLLËN 3 “MENAXHIMI DHE MOBILIZIMI I TË ARDHURAVE”	21
3.4 PROGRESI NË SHTYLLËN 4 “KONTABILITETI DHE MENAXHIMI I ZBATIMIT TË BUXHETIT”	25
3.5 PROGRESI NË SHTYLLËN 5 “KONTROLLI I BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK”	31
3.6 PROGRESI NË SHTYLLËN 6 “MBIKËQYRJA E JASHTME”	37
4. RISQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE	40
5. KOSTOJA E STRATEGJISË TË MFP-SË	43
6. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	44
SHKURTESAT DHE AKRONIMET	46
ANEKSI 1: STATUSI I MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË MFP PËR 2023	48

1. Vështrim i përgjithshëm i zbatimit të Strategjisë 2023-2030

1.1 Hyrje

Ky është Raporti i nëntë Vjetor i Monitorimit për Zbatimin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP), që mbulon periudhën nga 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023. Ai përfshin një tjetër vit me përpjekje reformash dhe i ofron informacion të detajuar Komitetit Drejtues dhe atij Teknik të MFP-së mbi progresin e arritur dhe sfidat e hasura në përmbushjen e objektivave dhe masave të strategjisë.

Ky raport ofron një vlerësim të kriterëve të pranueshmërisë së MFP-së në mënyrë që Bashkimi Evropian (BE) të ofrojë mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteri i pranueshmërisë së MFP-së kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe relevant për të përmirësuar menaxhimin e financave publike si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Në vetë-vlerësimin tonë, progresi i MFP-së ka qenë në përgjithësi i kënaqshëm, me 80% të treguesve të synuar të performancës të arritur plotësisht dhe 82.61% të aktiviteteve të përfunduara plotësisht.

Qeveria e Shqipërisë (QSH) ka bërë progres të mirë në zbatimin e Strategjisë së Reformave të Menaxhimit të Financave Publike. Zhvillimet për secilën shtyllë janë përshkruar në seksionet e mëposhtme.

1.2 Metodologjia e monitorimit

Drejtoria e Strategjive të Financave Publike dhe Mbështetjes Buxhetore udhëheq procesin e përgatitjes së raportit vjetor të monitorimit të MFP-së dhe dërgon kërkesën për raportim tek të gjithë drejtuesit e shtyllave, që janë strukturat drejtuese përgjegjëse për raportimin e zbatimit të strategjisë kundrejt planit të veprimit të kostuar, performancës ndaj objektivave; çdo vonese; ose ndryshimesh, identifikimit të risqeve të materializuara, risqeve të reja dhe masave zbutëse. Ky raport është përgatitur në bazë të instrumentit të monitorimit të miratuar nga Komiteti Drejtues nr. 11, datë 7 Prill 2020, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”. Struktura e raportit vjetor të monitorimit 2023 është hartuar në përputhje me metodologjinë SIPI bazuar në VKM nr. 290, datë 11.4.2020.

Vlerësimi i progresit të MFP-së bëhet në dy nivele: niveli i arritjeve të treguesve të performancës dhe niveli i aktiviteteve. Për sa i përket vlerësimin të treguesve të performancës, metodologjia e përdorur është: TP është shënuar me ngjyrë të gjelbër dhe emërtohet si i arritur nëse TP ka arritur objektivin 2023 sipas planit. TP shënohet me të kuqe nëse TP nuk e ka arritur objektivin e vitit 2023 sipas planit. Në raste të tjera, TP shënohet me të verdhë dhe konsiderohet pjesërisht i arritur. Sa i përket vlerësimin në nivel aktiviteti: me të gjelbër janë ato aktivitete të cilat kanë filluar në vitin 2023 dhe kanë përfunduar sipas planit brenda vitit 2023; me ngjyrë blu janë ato aktivitete të cilat kanë filluar në vitin 2023, janë në rrugën e duhur sipas planit në 2023, por data e përfundimit është përtej vitit 2023 (me përjashtim të atyre aktiviteteve objektivat e të cilave planifikohen periodikisht, në këto raste janë konsideruar si të përfunduara për atë vit dhe janë shënuar më të gjelbër); me të verdhë janë ato aktivitete të cilat pavarësisht datës së përfundimit janë pjesërisht në rrugën e duhur sipas planifikimit për vitin 2023; dhe me të kuqe janë ato aktivitete që nuk kanë filluar ende; dhe ‘Nuk kanë ecur’ janë ato aktivitete që nuk kanë progres të mirë dhe janë mundësisht në rrezik dështimi.

1.3 Vizibiliteti dhe konsultimet e MFP-së

Strategjia e Reformës së MFP-së shërben si kuadër për dialogun strategjik për të gjithë donatorët dhe aktorët e shoqërisë civile aktive në këtë sektor. Kuadri institucional për menaxhimin e reformave të MFP-së brenda MF-së përbëhet nga Komiteti Drejtues (KD), Komiteti Teknik dhe Drejtoria për reformën e MFP-së.

Një mbledhje e Komitetit Drejtues të MFP-së dhe një mbledhje e Komitetit Teknik u mbajtën gjatë vitit 2023. Më 26 qershor 2023 u organizua Komiteti i 11-të Teknik i Menaxhimit të Financave Publike (MFP). Fokusi i takimit ishte diskutimi i draft raportit vjetor të monitorimit të MFP-së për vitin 2022, sfidat dhe progresi i arritur si dhe diskutimi i hartimit të Strategjisë së re të MFP-së. Një fokus tjetër ishte ndjekja e proceseve të raportimit në fushën e menaxhimit të financave publike. Më 21 korrik 2023, raporti u diskutua dhe u miratua në mbledhjen e 16-të të Komitetit Drejtues të MFP-së (KD) dhe u publikua në faqen zyrtare të MF-së¹. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) u ftuan dhe morën pjesë në KD-në e 16-të të MFP-së, por nuk u dhanë komente. OShC-të janë ftuar gjithmonë në mbledhjet e KD-së për të dhënë kontributin dhe komentet e tyre për zbatimin dhe monitorimin e reformës së MFP-së. Më 13 tetor 2023, MF/DRPFM me mbështetjen e ekspertëve të Asistencës Teknike të BE-së për Qeverisje të Mirë, organizuan një takim me të gjitha njësitë/institucionet përgjegjëse të MFP-së. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi dhe dakordësimi për hapat e ardhshëm për zhvillimin dhe finalizimin e Strategjisë Sektoriale të MFP-së 2023-2030 dhe planit të veprimit shoqëruar 2023-2026, konkretisht u prezantua qëllimi dhe struktura e strategjisë sektoriale të MFP-së dhe plani i veprimit, metodologjia IPSIS dhe skedulimi i takimeve për fazën tjetër. Gjithashtu, MF/DRPFM me mbështetjen e ekspertëve të AT-së filloi të zhvillojë takime të dedikuara me njësitë përgjegjëse për secilin komponent të MFP-së me qëllim të përcaktimit të vizionit për vitin 2030 dhe masave të Planit të Veprimit 2023-2026.

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur dy mbledhje të Komitetit Drejtues të MFP-së dhe një mbledhje e Komitetit Teknik. Më 3 maj 2024 është organizuar Komiteti Drejtues i Menaxhimit të Financave Publike. Pjesë e këtij aktiviteti ishin të gjithë aktorët e përfshirë në planifikimin e reformës së MFP (anëtarë të Komitetit Teknik dhe Drejtues), partnerë ndërkombëtarë dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 është miratuar me VKM nr. 390, datë 12.6.2024 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare² më 26.06.2024 dhe në faqen e MF-së³. Më 10 tetor 2024 u organizua Komiteti Teknik i 12-të i Menaxhimit të Financave Publike (MFP). Në fokus të takimit ishte diskutimi i draft raportit vjetor të monitorimit të MFP-së për vitin 2023, sfidat dhe progresi i arritur, si dhe diskutimi i raporteve vlerësuese nga partnerët ndërkombëtarë. Më 31 tetor 2024, draft raporti u diskutua dhe u miratua në mbledhjen e 18-të të Komitetit Drejtues të MFP-së dhe do të publikohet në faqen e internetit të MF-së. Komiteti Drejtues i MFP-së kryesohej nga Ministri i Financave. Në takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve dhe drejtorive të MF-së të përfshirë në MFP dhe anëtarë të tjerë të Komitetit Drejtues, si dhe partnerë për zhvillim dhe organizata të shoqërisë civile. Në kuadër të transparencës dhe komunikimit me publikun, MF publikon në faqen e saj zyrtare të internetit çdo raport vjetor monitorimi në gjuhën shqipe dhe angleze.

¹ <https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/2022-PFM-Annual-Monitoring-Report.pdf>

² <https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/105/d896de92-1aea-4d73-991e-7a99cfeb934f>


³ <https://financa.gov.al/en/menaxhimi-i-financave-publike/>

2. Ecuria e Strategjisë në 2023

2.1 Arritjet në zbatimin e Shtyllave të Strategjisë MFP për 2023

Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres të mirë në zbatimin e Strategjisë së Reformave të Menaxhimit të Financave Publike. Progresi i MFP-së ka qenë në përgjithësi i kënaqshëm, me 80% të treguesve të synuar të performancës të arritur plotësisht. Në përgjithësi, grafiku më poshtë paraqet një vështrim të nivelit të arritjeve për secilën shtyllë, në nivelin e treguesve të performancës.

Grafiku 3: Niveli i arritjeve të TP-ve për secilën shtyllë



Gjatë vitit 2023, treguesit e performancës që kanë kontribuar kryesisht në nivelin e arritjeve të shtyllave janë: (i) Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) Nominal: diferenca e vlerave të parashikuara ndërmjet MF-së dhe FMN-së nuk duhet të jetë më e madhe se zero; (ii) Balanca Primare: duke filluar nga viti 2024, Balanca Primare do të mandatohet ligjërisht si rregull i ri fiskal dhe parashikohet të jetë jo më pak se zero; (iii) Përqindja e strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në përputhje me udhëzimet e SPI-së; (iv) Miratimi i DPP-së së bashku me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare; (v) Prezantimi i procedurave të përmirësuara të MIP-së (përfshirë mekanizmat përkatës të vendimmarrjes); (vi) Prezantimi nga MF i Software-it të Menaxhimit të Buxhetit Vendor dhe E-Platformës; (vii) Hartimi dhe miratimi i ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme; (viii) Përqindja e shfrytëzimit të Kanalit të Gjellbër; (ix) Koha e përpunimit të deklaratës doganore; (x) Numri i Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar; (xi) Numri shtesë i Institucioneve Buxhetore që kanë akses në SIFQ dhe arkivën elektronike (AE); (xii) Prodhimi i kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor bazuar në SNKSP sipas planit; (xiii) Përqindja e kontabilistëve të qeverisë që kanë përfunduar trajnimin SNKSP; (xiv) Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit i SMB-së i përgatitur dhe publikuar; (xv) Norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit; (xvi) Krijimi i kuadrit të duhur rregullator për vlerësimin dhe inventarizimin e asetëve publike; (xvii) Përgatitja e një regjistri të konsoliduar të asetëve në institucionet qendrore, në nivel njësie kontrolluese; (xviii) Përqindja e institucioneve publike që përmbushin kërkesat e MFK-së; (xix) Përqindja e institucioneve publike që kanë të vendosur mekanizma adekuat të llogaridhënies menaxheriale; (xx) Përqindja e institucioneve publike që kanë adoptuar të gjitha mjetet e menaxhimit të riskut; (xxi) Përqindja e institucioneve publike që mbulohe nga auditimet e brendshme vjetore; (xxii) Përqindja e njësisve të auditimit të brendshëm që kanë krijuar dhe zbatuar PPSC në

përputhje me standardet në fuqi; (xxiii) Përqindja e audituesve të brendshëm që përputhen me kërkesat e ZHVP; (xxiv) Hartohet dhe miratohet paketa për marrjen e besimit IPA-III.

2.2 Ndikimi i zbatimit të strategjisë së MFP-së në përputhje me axhendën e Integrimit Evropian

Reforma e menaxhimit të financave publike vazhdon të jetë një prioritet i qeverisë shqiptare jo vetëm si një nga parakushtet për anëtarësimin në BE në kuadër të reformës së administratës publike (RAP), por synon edhe mbështetjen e një ekonomie më të zhvilluar me shërbime më të mira për qytetarët. Progresi i kënaqshëm në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, duke përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, si dhe relevanca dhe besueshmëria në vazhdimësi e programit të reformës është një nga kushtet e përgjithshme për disbursimin e kësteve të mbështetjes buxhetore nën fondet IPA. Në këtë kuadër, Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030, adreson disa sfida me të cilat po përballlet Shqipëria në rrugën e saj drejt BE-së. Për më tepër, progresi i MFP-së është pjesë e disa raporteve të monitorimit dhe vlerësimit siç janë: Raporti i Grupit të Posaçëm të Reformës së Administratës Publike (GP RAP), Udhërrëfyesi RAP, raporti i monitorimit SIGMA, Vlerësimi i PEFA-s dhe Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë.

Në lidhje me **GP RAP BE-Shqipëri**, ai shërben si platforma kryesore për të shtyrë përpara punën për RAP-in. Raportet periodike mbi ndjekjen e përfundimeve të GP RAP përgatiten nga Qeveria Shqiptare dhe në çdo mbledhje vjetore nxirren përfundime mbi fushat që duhen përmirësuar. Takimi i 11-të i GP RAP u mbajt në qershor 2023, në të cilin u lanë disa konkluzione operacionale si: (1) përgatitja (përmes një procesi konsultativ gjithëpërfshirës) dhe miratimi i Strategjisë së re të MFP-së. Shqipëria të sigurojë kostimin e duhur të aktiviteteve të parashikuara në strategjitë e reja; (2) të kryejë një vlerësim të ri PEFA gjatë vitit 2024; (3) të vazhdojë reformat për të parandaluar krijimin e detyrimeve të prapambetura, me fokus të veçantë në detyrimet e prapambetura ndaj pushtetit vendor (së bashku me përpjekjet për të forcuar menaxhimin financiar) dhe detyrimet e prapambetura në lidhje me çështjet gjyqësore; (4) të thjeshtojë proceset e vendimmarrjes dhe menaxhimit për investimet publike, pavarësisht nga burimi i financimit, nëpërmjet aplikimit të VKM-së për këtë çështje. Shqipëria të sigurojë burime të mjaftueshme në MF për rolin e mbikëqyrjes financiare. Shqipëria të përmirësojë më tej raportimin për investimet, duke përfshirë Partneritetet Publik-Private (PPP), duke zgjeruar mbulimin dhe cilësinë e raporteve të monitorimit; (5) të forcojë mbikëqyrjen e NSH-ve dhe vlerësimi i risqeve fiskale që burojnë nga NSH-të përmes përmirësimit të mbikëqyrjes dhe raportimit, dhe forcimit të vlerësimit të risqeve; dhe (6) të kryejë konsultime publike për draftin, të miratojë Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) dhe të monitorojë zbatimin e saj. Këto përfundime janë monitoruar dhe ndjekur nga MF, dhe progresi i tyre është raportuar në mbledhjen e 12-të të GP RAP të mbajtur në qershor 2024.

Lidhur me Udhërrëfyesin e RAP, pas takimit dypalësh ndërmjet Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Shqipërisë për Reformën e Administratës Publike (Grup Kapitulli 1) të mbajtur më 12 dhjetor 2022, Departamenti i Administratës Publike, si institucioni udhëheqës në këtë fushë, inicioi procesin për përgatitjen e Udhërrëfyesit të RAP për 6 fusha tematike nën RAP, ku “Menaxhimi i Financave Publike” është një nga fushat tematike. Përgatitja e Udhërrëfyesit të RAP filloi në fund të muajit mars 2023 dhe vazhdoi përmes takimeve dhe bashkëpunimit intensiv të njësisë të MF-së për përcaktimin e masave, dokument ky që u miratua me VKM Nr. 737, datë 13.12.2023. Gjatë vitit 2024, MF ka vazhduar të monitorojë zbatimin e masave dhe të raportojë progresin në baza tremujore.

Në vitin 2023 nuk u krye asnjë raport monitorimi SIGMA për fushën e MFP-së, megjithatë MF-ja ka vazhduar të monitorojë rekomandimet e lëna në **raportin e monitorimit SIGMA 2021**⁴. Ndërkohë, gjatë vitit 2023 SIGMA ka përditësuar Parimet e Administratës Publike për t'u përafuar me standardet më të fundit nga BE-ja, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZhe/OECD) dhe organizata të tjera ndërkombëtare, si dhe për të adresuar sfidat bashkëkohore. Kuadri i rishikuar synon të ndihmojë administratat publike të përshtaten me prioritetet politike në evoluim dhe kërkesat e qytetarëve duke qenë më dixhitale, më fleksibël, novatore dhe e ndërgjegjshme për mjedisin. Versioni i ri integron Parimet për zgjerimin e BE-së dhe rajonet fqinje, pasqyron qartë vlerat dhe standardet e BE-së dhe tani përfshin qeveritë rajonale dhe ato vendore. Procesi i vlerësimit të SIGMA për Shqipërinë nisi në janar 2024. Parimet e Administratës Publike janë të organizuara në 6 fusha tematike, 32 parime dhe 270 nënparime. Ministria e Financave është përgjegjëse për fushën tematike “Menaxhimi i Financave Publike”, si dhe kontribuon në 5 fushat e tjera tematike. Fusha tematike “Menaxhimi i Financave Publike” përbëhet nga 10 parime, ku 6 prej tyre lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e Ministrisë së Financave. Ministria e Financave ka bashkëpunuar gjithashtu dhe me institucione të tjera për hedhjen e të dhënave në sistem, siç janë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Brendshme; Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar. Gjatë periudhës shkurt – mars 2024, të dhënat janë mbledhur dhe ngarkuar në sistemin online PAR.IS, dhe në prill 2024 janë mbajtur takime të dedikuara me njësitë përgjegjëse. Raporti përfundimtar pritet të prezantohet në tetor 2024 dhe të publikohet në nëntor 2024.

Gjatë vitit 2023 Qeveria e Shqipërisë ka konfirmuar Vlerësimin PEFA për Shqipërinë që të fillojë në vitin 2024. Procesi i Vlerësimit PEFA për Shqipërinë filloi në maj 2024 dhe ka një afat përfundimtar të parashikuar deri në dhjetor 2024. Vlerësimi do të mbulojë të dhënat për vitet fiskale 2021, 2022, 2023. Vlerësimi PEFA 2024 synon t'i japë Qeverisë së Shqipërisë një diagnozë objektive të përditësuar të performancës së Menaxhimit të Financave Publike në nivel qendror bazuar në metodologjinë PEFA, mbështetur në 31 tregues të performancës: Në vijim janë fushat e MFP-së që do t'i nënshtrohen këtij vlerësimi: (i) planifikimi dhe zbatimi i buxhetit; (ii) marrëdhëniet fiskale ndërqeveritare; (iii) informacion i performancës për ofrimin e shërbimeve, (iv) akses publik në informacionin fiskal; (v) menaxhimi i investimeve publike; (vi) monitorimi i aseteve publike; (vii) parashikimet makroekonomike; (viii) menaxhimi i borxhit, (ix) administrimi i të ardhurave; (x) parashikueshmëria e alokimit të burimeve brenda vitit; (xi) shpenzimet për detyrimet e prapambetura; (xii) kontrollet e listës së pagave dhe kontrollet e brendshme mbi shpenzimet jopaga; (xiii) sistemi i prokurimit; auditimi i brendshëm dhe i jashtëm; integriteti i të dhënave financiare. Ky proces menaxhohet dhe mbikëqyret nga Qeveria e Shqipërisë, Delegacioni i BE-së, Fondi Monetar Ndërkombëtar; Banka Botërore, SECO dhe SIDA. Ministria e Financave në këtë proces luan rolin e koordinatorit dhe mbështetësit për ekipin e konsulentëve të pavarur të kontraktuar nga DBE.

Për sa i përket **raportit të BE-së për 2023 për Shqipërinë**⁵, gjetjet kryesore janë paraqitur në kutinë e mëposhtme.

- **Ligji organik i buxhetit (LOB)** është zbatuar në mënyrë sistematike në linjë me kalendarin buxhetor për vitin 2022. Në vitet e fundit, duke përfshirë edhe vitin 2022, rishikimet e buxhetit janë bërë kryesisht përmes akteve normative, shpesh me mungesë transparence dhe të

⁴ <https://www.sigmaweb.org/countries/albania-sigma.htm>

⁵ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

konfirmuara ex post nga Parlamenti. Kushtet e pasigurta ekonomike e kanë justifikuar këtë deri diku, por shihet i përshtatshëm kthimi në procedurat më të rregullta të rishikimit të buxhetit.

- Mbetet të krijohet **një organ i pavarur mbikëqyrës** me mandatin për të vlerësuar risqet fiskale dhe për të monitoruar pajtueshmërinë me rregullat ekzistuese fiskale.
- **Cilësia e programit buxhetor afatmesëm** është përmirësuar, por duhet të vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin në mënyrë konsistente të parashikimeve të të ardhurave dhe për forcimin e kufijve sektorialë për të mbështetur zbatimin e politikave nga ministrinë e linjës. Duhet të ruhen dhe të zgjerohen përpjekjet fillestare për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.
- **Transparenca buxhetore** mbetet përgjithësisht e kënaqshme me publikimin e të gjitha dokumenteve kyçe buxhetore. Megjithatë, nevojitet ende përmirësim i mëtejshëm në cilësinë dhe formatin e dokumenteve, duke përfshirë publikimin e raporteve të auditimit online në kohën e duhur.

Për më tepër, bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë përgjegjëse të MFP-së, rezulton se 10 nga 17 komponentët e reformës së MFP-së lidhen me kapitujt e SKZHIE, përfshirë grupimet themelore.

2.3 Ndikimi i zhvillimit të sektorit në rajon dhe/ose më gjerë

Ky seksion ofron një vështrim krahasues të treguesve kryesorë makroekonomikë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, me fokus në financat publike dhe performancën ekonomike. Supozohet se vendet e Ballkanit Perëndimor ndjekin kryesisht një axhendë të ngjashme të reformës së MFP-së, e lidhur me qëllimin e përgjithshëm të anëtarësimit në BE. Bazuar në të dhënat e paraqitura në Raportin e Rregullt Ekonomik të Ballkanit Perëndimor dhe siç paraqitet në tabelën e mëposhtme, krahasuar me vendet e tjera shfaqet një tablo e përzier e performancës së Shqipërisë. Rritja reale e PBB-së është më e larta në rajon pas Malit të Zi. Të ardhurat si përqindje e PBB-së janë më të ulëta në rajon, ndërsa balanca primare luhet dhe u kthye pozitive në vitin 2023. Borxhi si përqindje e PBB-së u ul në vitet e kaluara, por mbetet në një nivel të konsiderueshëm pranë 60%, në nivel të ngjashëm me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, por më i lartë se shtetet e tjera në rajon.


Tabela 1: Treguesit fiskalë në shtetet e Ballkanit Perëndimor 2021, 2022, 2023

Treguesit makro	Rritja reale e PBB-së, me çmime konstante tregu (%)			Të ardhura (% e PBB)			Balanca primare (% e PBB)			Borxhi (% e PBB)		
	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023
Shqipëria	8.9	4.9	3.3	27.5	26.8	27.9	-2.7	-1.8	0.7	75.4	65.3	59.8
Bosnjë dhe Hercegovinë	7.3	3.8	1.9	43.2	39.9	39.4	1.0	1.2	-0.1	37.8	35.8	36.2
Kosova	10.7	4.3	3.1	27.4	27.9	29.3	-0.9	-0.1	0.2	21.1	19.7	17.2
Mali i Zi	13.0	6.4	6.0	44.0	38.6	42.8	0.2	-3.3	2.3	84.0	69.2	60.7
Maqedonia e Veriut	4.5	2.2	1.0	32.1	32.1	34.9	-4.1	-3.4	-3.4	60.3	59.0	62.0
Serbia	7.7	2.5	2.5	43.2	43.4	42.9	-2.4	-1.5	0.1	57.1	55.6	52.6

2.4 Aktivitetet e shtyllave që nuk përparuan sipas planit


Bazuar në vetë-vlerësimin, progresi i MFP-së ka qenë i kënaqshëm, me 82,61% të progresit në nivel aktiviteti (kjo përfshin “28,26% të përfunduar” dhe “54,35% në rrugën e duhur”). Grafiku më poshtë paraqet një vështrim të statusit të aktiviteteve për të gjashta shtyllat.

Grafiku 4: Niveli i përgjithshëm i aktiviteteve të strategjisë së MFP



Ndërkohë, ka disa aktivitete që nuk kanë ecur sipas planit. Grafiku më poshtë paraqet një përmbledhje të nivelit të arritjeve në “pjesërisht në rrugën e duhur” për secilën shtyllë, në nivel aktiviteti. Në total, 17.39% e aktiviteteve janë pjesërisht në rrugën e duhur. Puna do të vazhdojë në vitin e ardhshëm për këto aktivitete.

Grafiku 5: Aktivitete pjesërisht në rrugën e duhur, 2023



Sfidat kryesore që potencialisht ndikojnë negativisht në zbatimin e aktiviteteve ishin kryesisht të lidhura me disponueshmërinë e pamjaftueshme të burimeve njerëzore dhe ndryshimet e vonuara ligjore/rregullatore.

2.5 Zbatimi i buxhetit të përgjithshëm

Shumica e reformave të përfshira në këtë strategji janë reforma politikash. Puna për formalizimin e këtyre reformave në trajtën e legjislacionit dhe rregulloreve të reja dhe/ose të modifikuara në përgjithësi nuk kërkon burime financiare shtesë. Stafit ekzistues i institucioneve të përfshira në zbatimin e reformave kanë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të arritur rezultatet e dëshiruara. Plani i

Veprimet 2023-2026 parashikon që kostoja totale shtesë për zbatimin e aktiviteteve është 11.58 milionë euro nga të cilat 811,152 euro do të mbulohen nga Buxheti i Qeverisë dhe 10,77 milionë euro nga Partnerët për Zhvillim Ndërkombëtar. Ndërsa buxheti i planifikuar për Planin e Veprimeve 2023 ishte 1.348 milionë euro (107,819 euro nga Buxheti i Qeverisë dhe 1.232 milionë euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim). Gjatë vitit 2023, burimet totale të përdorura për zbatimin e reformës ishin 104,738 euro nga Buxheti i Qeverisë dhe 127,415⁶ euro nga Partnerët Ndërkombëtarë për Zhvillim.

⁶ Ka një ndryshim në totalin e planifikuar për vitin 2023, për shkak të konvertimit të vlerës nga ALL në Euro. Ndryshimi është bërë në aktivitetin 3.3.1.1 “Vazhdimi i zhvillimit të një fuqie punëtore më profesionale dhe më të shkathët përmes përmirësimit të praktikave të burimeve njerëzore dhe ofrimit të zhvillimit të kapaciteteve” nën komponentin 3.3 Menaxhimi i Doganor. Gjithashtu ka një gabim material në totalin e planifikuar për vitin 2023 në lidhje me Komponentin 2.4 “Financat Vendore”, aktiviteti 2.4.3.1 “Përgatitja e një dokumenti specifik të Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV)”.

3. Progresi në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë së MFP

Më poshtë janë përshkruar detajet specifike të zhvillimeve për secilin Objektiv Specifik.

3.1 Progresi në Shtyllën 1 “Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut”

Gjatë vitit 2023, janë ruajtur dhe përmirësuar më tej sistemet për zhvillimin dhe monitorimin e politikave fiskale të shëndosha të bazuara në rregullat fiskale, parashikimet e avancuara makroekonomike dhe praktikat solide të menaxhimit të risqeve fiskale. Të gjitha objektivat e vendosura për vitin 2023 janë arritur ose janë tejkaluar dhe janë të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 1


Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2023	Vlera faktike 2023
Objektivi specifik (Komponenti) 1.1 Programim makroekonomik i matur dhe realist				
1	PBB nominale: diferenca e vlerave të parashikuara ndërmjet MF-së dhe FMN-së nuk duhet të jetë më e madhe se zero.	0.0 miliardë Lek (2022)	≤ 0	-0.8 miliardë Lek
2	Balanca Primare: duke filluar nga viti 2024, Balanca Primare do të mandatohet ligjërisht si rregull i ri fiskal dhe parashikohet të jetë jo më pak se zero.	-1.8 % e PBB (2022)	> 0	0.7 % e PBB
Objektivi specifik (Komponenti) 1.2 Krijimi i një Analize gjithëpërfshirëse të Qëndrueshmërisë së Borxhit⁷				
Objektivi specifik (Komponenti) 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale⁸				
1	Prezantimi i Deklaratës vjetore të Riskut Fiskal.	-	-	DVRF e pilotuar
Objektivi specifik (Komponenti) 1.4 Këshilli Fiskal⁹				

Progresi i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023. 80% e aktiviteteve janë përfunduar dhe 20% janë pjesërisht në rrugën e duhur.

⁷ Për objektivin specifik (komponentin) 1.2 “Krijimi i një analize gjithëpërfshirëse të qëndrueshmërisë së borxhit”, nuk janë përcaktuar vlera të synuara për vitin 2023.

⁸ Për objektivin specifik (komponentin) 1.3 “Menaxhimi i risqeve fiskale”, nuk janë përcaktuar vlera të synuara për vitin 2023. Sipas Strategjisë së MFP 2023-2030 dhe PV PFM 2023-2026, DRF kishte një objektiv që të pilotohej në vitin 2024. Por kjo u arrit më herët, pasi DRF u pilotua në 2023.

⁹ Për objektivin (komponentin) specifik 1.4 “Këshilli Fiskal”, nuk janë përcaktuar vlera të synuara për vitin 2023.

Grafiku 6: Statusi për vitin 2023 të aktiviteteve në Shtyllën 1


Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2023

Objektivi Specifik 1.1 Programimi Makroekonomik i Matur dhe Realist

Treguesit e Performancës

Diferenca midis Ministrisë së Financave dhe FMN-së për parashikimet e PBB-së është më e vogël se zero dhe arrin në -0.8 milionë lekë; dhe balanca primare është jo më pak se zero dhe arrin në 0.2% të PBB-së. Të dy treguesit tregojnë përputhshmëri me rregullat fiskale për vitin 2023. Treguesi që specifikon diferencën në parashikimin e PBB-së është prodhuar si një krahasim midis PBB-së së parashikuar siç paraqitet në Ligjin e Buxhetit Vjetor dhe nivelit të PBB-së nominale të publikuar në World Economic Outlook. Vlera nominale e PBB-së e parashikuar nga MF për vitin 2023 ishte 2,311.7 miliardë lekë, ndërsa PBB-ja e parashikuar nga FMN në “World Economic Outlook”, më i fundit i publikuar në momentin kur ligji i buxhetit vjetor paraqitet për miratim në Kuvend (tetor 2023), ishte 2,312.5 miliardë lekë. Diferenca në vlerat e parashikuara mes MF-së dhe FMN-së është -0.8 miliardë lekë. Për sa i përket balancës primare: duke filluar nga viti 2024, balanca primare do të mandatohet ligjërisht si rregull i ri fiskal dhe parashikohet të jetë jo më pak se zero, vlera faktike gjatë vitit 2023 ishte 0.7% e PBB-së (nga ≥ 0 e planifikuar). Ky tregues matet si diferencë ndërmjet huamarrjes neto të qeverisë, duke përfshirë pagesat e interesit në pasqyrën e konsoliduar të qeverisë. Në çdo ligj buxhetor vjetor duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim, balanca primare aktuale nuk mund të jetë negative, duhet të jetë të paktën e balancuar ose pozitive (sufiçit primar). Balanca primare rezultoi në një përmirësim të ndjeshëm, konkretisht për vitin 2023 ai shënoi 0.7% të PBB-së, nga -1.8% e PBB-së në vitin 2022, duke respektuar kështu rregullin fiskal një vit më herët.

PBB nominale e parashikuar e MF dhe FMN	(në miliardë ALL)		
	2021	2022	2023 P.
MF	1,856.2	2,138.3	2,311.7
FMN (World Economic Outlook)	1,856.2	2,138.3	2,312.5
Diferenca MF – FMN (Diferenca e vlerave të parashikuara nuk duhet të jetë me e madhe se zero)	0.0	0.0	-0.8

Burimi: Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal, dorëzuar më 24.01.2024, me VKM nr. 41¹⁰

¹⁰<https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Kuadri-Makroekonomik-e-Fiskal-p%C2%BDR-periodh%C2%BDn-2025-2027-VKM-Nr.-41-dt.-24.1.2024-2.pdf>

Masat dhe aktivitetet

Parashikimi i kujdesshëm dhe real i treguesve makroekonomikë, krahasimi i vazhdueshëm (analiza krahasuese) i projeksioneve me ato të parashikuesve të pavarur ndërkombëtarë dhe respektimi i rregullave fiskale ka vazhduar edhe në vitin 2023. Parashikimet dhe analizat krahasuese dhe përputhshmëria me rregullat fiskale u shpërndanë në mënyrë transparente përmes disa dokumenteve duke përfshirë (i) "Kuatrin makroekonomik dhe fiskal dorëzuar në datën 24.01.2024, me VKM nr. 41; (ii) "Programin e Reformave Ekonomike 2024-2026" dorëzuar më 11.01.2024 me VKM nr. 12; dhe (iii) "Kuatri makroekonomik dhe fiskal 2025-2027", dorëzuar më 19.06.2024, me VKM nr.399 dhe (iv) "Raporti i zbatimit të buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale". Të gjitha raportet janë dorëzuar dhe publikuar në përputhje me afatet kohore të përcaktuara.

Ruajtja e financave publike të shëndosha dhe kuadrit fiskal elastik është në rrugën e duhur nëpërmjet përputhshmërisë të rreptë me rregullat fiskale të mandatuara me ligj. Pajtueshmëria e rreptë me rregullat fiskale të mandatuara me ligj është arritur për vitin 2023, duke nxitur një kuadër fiskal elastik dhe duke përforcuar stabilitetin dhe llogaridhënien e financave publike.

Rekrutimi i stafit të specializuar dhe zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara të stafit të DPPMF-së është pjesërisht në rrugën e duhur. Trajnimet e stafit ekzistues dhe forcimi i kapaciteteve janë një proces i vazhdueshëm, ndërsa rekrutimi për stafin të ri duhet të bëhet publik në faqen zyrtare të nëpunësve civilë, e cila operohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP).

Objektivi Specifik 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale**Masat dhe aktivitetet**

Në vitin 2023, u hartua Deklarata e parë pilot e Risqeve Fiskale për vitin 2022, e cila shërbeu si një fazë ushtrimi, duke u fokusuar në koordinimin dhe konsolidimin e informacionit të ofruar nga të gjitha njësitë raportuese, duke hedhur bazat për përmirësimin e menaxhimit të risqeve fiskale në të ardhmen.

Sfidat kryesore dhe hapat e ardhshëm

Nuk ka pasur sfida kryesore gjatë vitit 2023.

3.2 Progresi në Shtyllën 2 "Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent"

Gjatë vitit 2023 është punuar për të përmirësuar më tej praktikën e planifikimit buxhetor dhe të monitorimit të zbatimit të buxhetit. 57.14% e objektivave të TP-ve janë arritur gjatë vitit 2023 kurse për 42.86% të objektivave të TP-ve informacioni nuk është i disponueshëm. Në përgjithësi, analiza tregon progres pozitiv në shumicën e fushave, veçanërisht në Menaxhimin e Investimeve Publike dhe Financat Vendore. Pajtueshmëria me objektivat në përgjithësi tregon përfshirjen efektive të procedurave të përmirësuar dhe të e-platfomës. Tabela më poshtë paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës të Shtyllës 2 "Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent".


Tabela 3: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 2

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2023	Vlera faktike 2023
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.1 Planifikimi Strategjik i Integruar				
1	Përçindja e strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në përputhje me udhëzimet e SPI-së	65% (2022)	70%	70%
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.2 Planifikimi Buxhetor Afatmesëm				
6	Prezantimi i rishikimeve të shpenzimeve.	-	Metodologjia e përgatitur dhe rregulluar	NA
7	Prezantimi i analizës së hendekut gjinor si pjesë e BPGJ-së	-	Metodologjia e analizës së hendekut gjinor e përgatitur dhe e rregulluar	NA
8	Prezantimi i buxhetimit të gjelbërt të përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike	-	Metodologjia për Buxhetimin e Përgjegjshëm ndaj ndryshimeve klimatike është përgatitur dhe rregulluar	NA
9	Miratimi i DPP-së së bashku me Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare	(2022)	Bashkëpunimi me Ministrinë e Linjës dhe miratimi me VKM çdo fillim viti	100% e DPP-së përfshirë Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare hartuar dhe miratuar me VKM nr. 447, date 26.07.2023
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.3 Menaxhimi i Investimeve Publike				
2	Prezantimi i procedurave të përmirësuara të MIP-së (përfshirë mekanizmat përkatës të vendimmarrjes)	-	Operacionalizimi i procedurave të MIP-së	Operacionalizimi i procedurave të MIP-së
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.4 Financat Vendore				
2	Prezantimi nga MF i Software-it të Menaxhimit të Buxhetit Vendor dhe E-Platformës.	-	E-platforma e zhvilluar dhe e miratuar	SMBV dhe e-platforma zhvilluar dhe miratuar
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.5 Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit¹¹				

¹¹ Për objektivin specifik (komponenti) 2.5 "Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit", nuk janë përcaktuar vlera të synuara për vitin 2023.

Progres i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023. 25% janë përfunduar, 50% janë në rrugën e duhur dhe 25% janë pjesërisht në rrugën e duhur.

Grafiku 7: Statusi për vitin 2023 të aktiviteteve në Shtyllën 2



Progresi i (Komponentëve) Objektivave Specifikë bërë gjatë vitit 2023

Objektivi Specifik 2.1 Planifikimi Strategjik i Integruar

Treguesit e Performancës

Pajtueshmëria me Udhëzimet e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) është përmirësuar në vitin 2023, me 70% të të gjitha strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara në përputhje me udhëzimet e SPI-së. Strategjitë dhe planet e veprimit të zhvilluara në përputhje me udhëzimet e SPI-së: (i) Strategjia e Ekonomisë Blu 2023-2030; (b) Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030; (iii) Strategjia “S3”, 2023-2030; (iv) Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015 – 2030; (v) Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030; (vi) Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 dhe Plani i Veprimit; (vii) Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030; (viii) Strategjia Sektoriale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030; (ix) Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030; (x) Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023-2027; (xi) Strategjia Sektoriale e Ujësjellës Kanalizimeve 2023-2030.

Për vitin 2024 është planifikuar përmirësimi i mëtejshëm i përputhshmërisë së strategjive dhe planeve të veprimit që monitorohen në përputhje me udhëzimet e SPI-së.

Objektivi Specifik 2.2 Planifikimi Buxhetor Afatmesëm

Treguesit e Performancës

Për sa i përket Planifikimit Buxhetor Afatmesëm, për vitin 2023, vlera faktike nuk është e disponueshme për: (i) prezantimi i rishikimeve të shpenzimeve; (ii) prezantimi i analizës së hendekut gjinor (AHGj) si pjesë e Buxhetit të Përgjigjshëm Gjinor (BPGj) dhe (iii) prezantimi i buxhetimit të gjelbërt të përgjigjshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Në korrik 2023, u miratua VKM Nr. 447, datë 26.07.2023, në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 887, “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”. Ky vendim përfshin gjithashtu si pjesë përbërëse Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP). NSPP përfshin gjithsej 145 projekte, të kategorizuara sipas

statusit të maturimit, si më poshtë: 60 projekte të maturuar, 36 projekte pjesërisht të maturuar dhe 49 projekte të pa maturuar.

Objektivi Specifik 2.3 Menaxhimi i Investimeve Publike

Treguesit e Performancës

Pas miratimit të VKM nr. 887 “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike” në fund të vitit 2022, kuadri rregullator për MIP të shëndoshë u zhvillua më tej me një udhëzim për kufijtë financiarë specifikë sipas sektorëve që përcakton projektet strategjike të investimeve publike dhe urdhrin për vlerësimin e rëndësisë strategjike të projekteve për Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Në korrik 2023, referuar dispozitave të VKM nr. 887 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” u miratua VKM nr. 447, datë 26.07.2023, ku u miratua Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP). Drejtoria e MIP-së ka ndjekur me përpikëri procedurat e VKM-së për fazën e parë dhe të dytë të përgatitjes së PBA 2024-2026 dhe ligjit të buxhetit të vitit 2024.

Masat dhe aktivitetet

Paralelisht, në vitin 2023 janë ndërmarrë disa aktivitete trajnuese për të siguruar zbatimin e duhur të VKM 887/2022 nga të gjitha institucionet publike. Ministria e Financave, me mbështetjen e Bankës Botërore, organizoi në fund të muajit mars 2023 një workshop me përfaqësues të ministrive të linjës. Në workshop u shpjeguan dhe u diskutuan ndryshimet kryesore në VKM-në e re si dhe u dhanë ushtrime me shembuj konkretë. Në mars 2023, SASPAC organizoi një workshop me të gjitha institucionet përkatëse qeveritare për t'i udhëzuar mbi metodologjinë e re për përgatitjen e formularëve të Vlerësimit të Rëndësisë Strategjike, të cilat janë thelbësore për përgatitjen, vlerësimin dhe procesin e përzgjedhjes të projekt propozimeve të reja në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Ministria e Financave ka nisur procesin e përshtatjes dhe përmirësimit të mëtejshëm të modulit MIP të Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar të Shqipërisë (SIMFSH) pas miratimit të VKM 887/2022, që përfshin procedurat e rishikuara të MIP. U planifikuan takime me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit për të kryer përmirësime në sistem. Baza ligjore e VKM nr. 887/2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” u plotësua me Udhëzimin e miratuar të Ministrit të Financave nr. 4, datë 20.02.2023 (për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit) dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të SASPAC nr. 41, datë 25.01.2023 (për përgatitjen e formularit të Vlerësimit të Rëndësisë Strategjike), i cili është i detyrueshëm për të gjithë projektet e reja të dorëzuara që janë klasifikuar si projekte me rëndësi strategjike sipas VKM Nr. 887/2022. Udhëzimi i Ministrit të Financave përcakton pragun indikativ për çdo sektor ekonomik, i cili përcakton nëse një projekt kualifikohet si strategjik. Nga ana tjetër, urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të SASPAC miraton formularin që duhet të plotësohet për të vlerësuar objektivisht rëndësinë strategjike të çdo projekt-propozimi që kërkon hyrjen në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Objektivi Specifik 2.4 Financat Vendore

Treguesit e Performancës

Me qëllim përmirësimin e MFP-së në nivel vendor, është zhvilluar dhe miratuar Sistemi i ri i Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) për përgatitjen dhe monitorimin të buxhetit nën kombëtar. Pas përgatitjes së dokumentit të detajuar specifik për SMBV-në, softueri u zhvillua dhe u krijua platforma elektronike në të cilën ai funksionon.

Masat dhe aktivitetet

Softueri i ri u prezantua në të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027. Ky sistem i ri është përdorur nga 61 bashki dhe 12 njësi administrative për përgatitjen e PBA-së 2025-2027.

Objektivi Specifik 2.5 Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit

Masat dhe aktivitetet

Monitorimi dhe raportimi për projektet e investimeve publike është përmirësuar gradualisht përmes zbatimit të procedurave për monitorimin e MIP-së, të miratuara rishtazi. Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të raportojnë në Ministrinë e Financave për zbatimin e projekteve të investimeve publike në përputhje me aneksin 2 të vendimit 887/2022 “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nuk ka pasur sfida kryesore, pasi që të gjitha aktivitetet janë përfunduar dhe në rrugën e duhur, përveç aktivitetit që kontribuon në operacionalizimin e procedurës për përmirësimin e menaxhimit të investimeve publike.

3.3 Progresi në Shtyllën 3 “Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave”

Reformat që synojnë përmirësimin e sistemeve për mobilizimin dhe menaxhimin e të ardhurave kanë vazhduar edhe në vitin 2023 në përputhje me planin e veprimit të MFP-së si dhe me draftin e SAA 2022-2026 dhe Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare. Të gjitha objektivat e TP-ve janë përmbushur. Në kuadër të komponentit të menaxhimit të taksës së pasurisë u hartua një projektligj i ri “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme”, që iu nënshtrua procesit të konsultimit publik. Administrata doganore ka reduktuar kohën e përpunimit të deklaratave doganore dhe ka ruajtur numrin e operatorëve ekonomikë të autorizuar. Shfrytëzimi i kanalit të gjelbër ishte 28% gjatë vitit 2023.

Tabela më poshtë përmbledh statusin e arritjes së treguesve të performancës për Shtyllën 3 Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave.

Tabela 4: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 3


Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2023	Vlera faktike 2023
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.1 Menaxhimi i taksave ¹²				
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.2 Menaxhimi i taksës së pasurisë				
1	Hartimi dhe miratimi i ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme	-	Hartuar ligji për taksën mbi pasurinë e paluajtshme	Ligji për taksën mbi pasurinë e paluajtshme dorëzuar dhe

¹² Për Objektivin Specifik (Komponenti) 3.1 Menaxhimi i taksave, nuk janë përcaktuar vlera të synuara për vitin 2023.

				rishikuar nga konsultimi publik
Objektivi Specifik (Komponenti) 3.3 Menaxhimi doganor				
1	Përqindja e shfrytëzimit të Kanalit të Gjellbër	-	28%	28%
2	Koha e përpunimit të deklaratës doganore	-	99.1 minuta	97.7 minuta
3	Numri i operatorëve ekonomikë të autorizuar	-	13	13

Progres i kënaqshëm është bërë edhe drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023. 78.57% janë në rrugën e duhur, 14.29% janë pjesërisht në rrugën e duhur dhe 7.14% e aktiviteteve janë përfunduar.

Grafiku 8: Statusi për vitin 2023 të aktiviteteve në Shtyllën 3



Progresi i Komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2023

Objektivi Specifik 3.1 Menaxhimi i Taksave

Treguesit e Performancës

Nga janari 2022, Qeveria e Shqipërisë ka nisur zbatimin e masave të parashikuara në draftin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) 2022-2026. Si rezultat i këtyre masave, të ardhurat tatimore në vitin 2023 janë rritur në krahasim me vitin 2019, dhe në vitin 2024 do të arrijnë në 26.7% të PBB-së, nga 25.2% në 2019. Zbatimi i masave të politikave fiskale sipas rekomandimeve të FMN-së ndër vite ka nisur me "Paketën Fiskale 2022" dhe ka vazhduar me "Paketën Fiskale 2023" dhe "Paketën Fiskale 2024". Ndryshimet në politikat fiskale kanë synuar zgjerimin e bazës tatimore, uljen e detyrimeve tatimore, heqjen e normave tatimore të reduktuara dhe atyre preferenciale. Ndryshimet e bëra përfshijnë legjislacionin tatimor indirekt (akciza dhe TVSH), si dhe taksat direkte mbi të ardhurat e subjekteve dhe personave fizikë. Është miratuar ligji i ri "Për tatimin mbi të ardhurat", i cili zgjeron bazën tatimore, vendos taksimin e profesioneve të lira dhe heq tarifën e reduktuar të tatimit për industrinë e TI-së. Efekti pozitiv i politikës tatimore për vitin 2023 është mbi 15 miliardë lekë, ose 0.7% e PBB-së.

Lidhur me miratimin e SAA 2024-2026, grupi i punës në Ministrinë e Financave ka hartuar versionin e parë. Drafti do të procedohet për konsultim. Afati i fundit i miratimit të SAA-së është dhjetor 2024.

Masat dhe aktivitetet

Me kryerjen e trajnimeve të stafit, kapacitetet institucionale për të analizuar dhe zhvilluar politikat tatimore dhe për të menaxhuar reformat tatimore janë rritur gradualisht. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka zhvilluar trajnime me asistencën e FMN-së për Analizën e të Dhënave të Mëdha dhe Mashtrimin Ndërkombëtar Tatimor. DPT ka zhvilluar gjithashtu trajnime me asistencën e Administratës Tatimore Suedeze në lidhje me Menaxhimin të Përputhshmërisë së Risqeve, Shërbimin e Tatimpaguesve, Auditimin, Shkëmbimin Automatik të Informacionit dhe Kulturën e Integritetit. Stafi i DPT ka kryer trajnime në Qendrën e Ekselencës në Financë dhe IOTA.

Me miratimin e strukturës së re të Ministrisë së Financave në vitin 2024, u krijua një drejtori e re për parashikimin, statistikën dhe analizën e të ardhurave tatimore në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Tatimore në Ministrinë e Financave.

Janë në rrugën e duhur aktivitetet që kontribuojnë në zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave për të reduktuar hendekun e pajtueshmërisë me TVSH-në përmes përmirësimit të qasjeve të menaxhimit të risqeve për sektorët e identifikuar me risk të lartë dhe përdorimit të sistemit të fiskalizimit për të maksimizuar të ardhurat nga TVSH-ja. Me qëllim përmirësimit e qasjes së menaxhimit të risqeve për sektorët me risk të lartë, u krijua Komiteti i Riskut, i cili për vitin 2023 ka marrë 14 vendime. Këto vendime janë marrë gjatë vitit 2023 nga Komiteti i Riskut i krijuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore nr.42, datë 23.02.2023, në të cilin marrin pjesë drejtuesit e lartë të Administratës Tatimore. Këto vendime lidhen me fenomene dhe risqe të evidentuara dhe të vlerësuara, të cilat trajtohen nga Drejtoria Rajonale e Administratës Tatimore ose nga drejtoritë funksionale në DPT. Çdo vendim i Komitetit të Riskut ka mesatarisht 8 fenomene risku me të cilat merret. Rregullat dhe raportet e Inteligjencës së Biznesit janë zhvilluar në Modulin e Riskut Financiar, i cili përdor të dhëna nga procesi i fiskalizimit (Faturimi Elektronik). Gjithashtu, gjatë vitit 2023 në sistemin C@T janë zbatuar rregullat lidhur me listat e pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Është hartuar dhe zbatuar plani sektorial i turizmit. Sektori i turizmit konsiderohet me risk të lartë pasi ka një sërë fenomenesh të rrezikshme që kanë të bëjnë me mashtrimin e regjistrimit të TVSH-së, mos pagesës së TVSH-së, nëndeklarimit të qarkullimit, nëndeklarimit të pagave, evazioneve që kanë të bëjnë me tatimin në burim etj. Për sa i përket përdorimit të sistemit të fiskalizimit për maksimizimin e të ardhurave nga TVSH-ja, automatizimi i procesit të parambushjes së librave të blerje/shitjes nga Administrata Tatimore është kryer me synimin përfundimtar për parambushjen e deklaratës së TVSH-së (për tu përfunduar në vitin 2026). Gjithashtu, gjatë vitit 2023 janë trajtuar edhe tatimpaguesit që shmangin regjistrimin e TVSH-së. Janë identifikuar tatimpaguesit që shmangin regjistrimin për detyrimin tatimor të TVSH-së. Në vitin 2023 janë +2068 tatimpagues ose 6.6% më shumë me TVSH krahasuar me vitin 2022. Të dhënat sasiore dhe cilësore nga tatimi janë përdorur për evidentimin e çdo evazioni në deklarin dhe pagesën e TVSH-së.

Ka përfunduar aktiviteti që kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e një qasjeje të integruar për reduktimin e punës së nëndeklaruar dhe të padeklaruar përmes forcimit të dispozitave ligjore për sanksionet për kundërvajtjet që lidhen me punëtorët e padeklaruar dhe nëndeklarimin. Ndryshimet ligjore u miratuan me paketën fiskale të vitit 2023, konkretisht u prek pika 3, neni 119 i ligjit për procedurat tatimore.

Në vitin 2023 u miratuan ndryshime ligjore që mundësojnë dhe i japin kompetencë Administratës Tatimore për regjistrimin dhe vlerësimin e individëve me pasuri të madhe të pashpjegueshme bazuar në të dhënat e saj dhe të palëve të treta. Ky është një hap i rëndësishëm për sigurimin e taksimit të çdo pasurie të pajustificuar brenda dhe jashtë vendit dhe mundëson vlerësimin e rasteve të

pasurisë së madhe të pashpjegueshme të individëve duke u dhënë kompetencë ligjore inspektorëve për të dhënë vlerësime tatimore nëpërmjet metodave indirekte veçanërisht për individët që nuk marrin pjesë në Programin e Deklarimit Vullnetar.

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për tatimpaguesit është pjesërisht në rrugën e duhur. Ka nisur hartimi i strategjisë së ofrimit të shërbimit të tatimpaguesve, është vendosur në funksion qendra e thirrjeve dhe trajnimi i stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ofrohet nga Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore dhe ASPA. Strategjia e ofrimit të shërbimeve për tatimpaguesit synon të përmirësojë produktet dhe shërbimet tatimore. Procesi i zhvillimit të kësaj strategjie ka nisur me asistencën e Agjencisë Suedeze të Taksave (AST) përmes hartimit të pyetësorit që mat kënaqësinë e tatimpaguesve. Përmirësimi i efikasitetit të qendrës kombëtare të thirrjeve me një proces të strukturuar përshkallëzimi për të trajtuar pyetjet me kompleksitete të ndryshme është në rrugën e duhur. Qendra e thirrjeve është funksionale dhe trajton rastet e vendimmarrjeve të Komitetit të Riskut. Ajo është plotësisht funksionale dhe trajton listat e tatimpaguesve të përcaktuara nga Komiteti i Riskut për fenomene të ndryshme të përcaktuara kryesisht me risk të ulët.

Programe të reja për zhvillimin e kapaciteteve janë duke u zhvilluar nga akademia e tatimeve (Qendra Trajnuese e Administratës Tatimore dhe Doganore), universitetet dhe partnerët e tjerë. Administrata tatimore trajnohet në mënyrë të vazhdueshme nga Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore dhe nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA). Gjatë vitit 2023 janë mbajtur trajnime specifike për Ligjin e ri për “Tatimin mbi të Ardhurat”.

Objektivi Specifik 3.2 Menaxhimi i Taksës së Pasurisë

Treguesit e Performancës

Ministria e Financave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe Agjencinë Suedeze të Taksave ka hartuar projektligjin e ri “Për taksën e pasurisë së paluajtshme”. Ky projektligj do të vendosë taksimin e pasurisë bazuar në vlerën e tregut sipas një metodologjie që përfshin standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe konceptet/elementet e vlerës së tregut. Ky projektligj i është nënshtruar procesit të konsultimit nëpërmjet: publikimit në faqen zyrtare: konsultimipublik.gov.al, dëgjësave publike me bashkitë, universitetet, bizneset dhe organizatat dhe projektet që kanë në fokus pushtetin vendor. Këto komente do të përdoren së bashku me reagimet nga konsultimi i brendshëm me institucionet shtetërore për përmirësimin e projektligjit përpara se ai të kalojë për miratim në Kuvend.

Masat dhe aktivitetet

Miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit parashikohet për vitin 2025. Kjo do të lejonte kohë të mjaftueshme për hartimin dhe miratimin e të gjitha akteve të nevojshme nënligjore, si dhe përfundimin e proceseve të nevojshme për regjistrimin dhe vlerësimin e ndërtesave në Kadastrën Fiskale para vitit 2028, viti i synuar për fillimin e taksimit të ndërtesave në bazë të vlerës së tregut. Përfundimi i proceseve të nevojshme për regjistrimin dhe vlerësimin e tokës në Kadastrën Fiskale është planifikuar të përfundojë përpara vitit 2030, viti i synuar për fillimin e taksimit të tokës në bazë të vlerës së tregut.

Objektivi Specifik 3.3 Menaxhimi i Doganave

Treguesit e Performancës

Për përmirësimin e menaxhimit të doganave, koha efektive e përpunimit të deklaratave doganore është zvogëluar dhe kanë vijuar aplikimet e suksesshme nga operatorët ekonomikë. Nga ana tjetër, përqindja e shfrytëzimit të kanalit të gjelbër është poshtë synimit. Gjatë vitit 2023, koha mesatare për përpunimin e një deklarate doganore ishte 97.7 minuta kundrejt objektivit prej 99.1 minutash, që është rezultat i uljes së kohës së përpunimit të deklaratave në kanal in e verdhë. Koha e përpunimit të deklaratës në vitin 2022 ishte 95 min/deklaratë. Deri në fund të vitit, numri i operatorëve ekonomikë të autorizuar ishte 13 (nga 13 të planifikuar), falë vazhdimit të aplikimeve të suksesshme nga operatorët ekonomikë dhe kontrolleve dhe aprovimeve në kohë nga grupi i punës të Doganave. Deri në dhjetor 2022, gjithsej kanë aplikuar 20 kompani, 9 prej të cilave kanë marrë statusin e OEA. Shfrytëzimi i Kanalit të Gjelbër, i matur sipas përqindjes së shfrytëzimit pa kontroll fizik dhe doganor ishte 28% në vitin 2023. Gjatë vitit 2022, koha e kanalit të gjelbër u ul nga 32 në 31 minuta.

Masat dhe aktivitetet

Aktivitetet që kontribuojnë në modernizimin e proceseve të biznesit dhe menaxhimit të risqeve të Administratës Doganore janë në rrugën e duhur. Trajnimet e punonjësve ekzistues dhe të atyre të sapo punësuar ofrohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim zhvillimin e një fuqie punëtore profesionale dhe të zhdërvjellët.

Investimi në zhvillimin e softuerit të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Tarifave (SIMT) ka vazhduar deri në dhjetor 2023. Ai pritet të zbatohet brenda T4 2024.

Gjithashtu, janë në rrugën e duhur aktivitetet për zhvillimin e kuadrit të integritetit dhe luftën kundër informalitetit dhe korrupsionit, rritjen e OEA dhe zhvillimin e Dritares së Vetme Kombëtare. Plani i Integritetit është hartuar dhe miratuar në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Antikorrupsionit. Plani i Integritetit të Drejtorisë Antikorrupsion të Doganave është përafuar për objektivat kryesore me Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion të Qeverisë. Gjithashtu është miratuar Regjistri i Risqeve për Doganat. Fushatat informuese, përpunimi i aplikimeve dhe auditimi i OEA-ve potenciale janë kryer në mënyrë të vazhdueshme. Janë zhvilluar dhe miratuar Kushtet e Referencës për kontraktimin e një kompanie zbatuese për zhvillimin e Dritares së Vetme Kombëtare.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nuk ka pasur sfida kryesore, pasi të gjitha aktivitetet janë të përfunduara dhe në rrugën e duhur, përveç aktiviteve që kontribuojnë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për tatimpaguesit.

3.4 Progresi në Shtyllën 4 “Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit”

Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit është përmirësuar më tej në vitin 2023 dhe të gjitha objektivat e TP-ve janë arritur. Aksesit i institucioneve buxhetore në SIFQ dhe në Arkivin Elektronik është rritur. Gjithashtu, reformat e planifikuara të kontabilitetit dhe shtrirja e SNKSP janë në rrugën e duhur me një dokument konceptual të përgatitur për përditësimin e kuadrit ligjor dhe kontabilistët e qeverisë që po trajnohen. Si pjesë e menaxhimit të borxhit dhe të likuiditetit, janë përgatitur dhe publikuar Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit SMB dhe është konsoliduar norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit. Me qëllim përmirësimin e menaxhimit të aseteve, koncept

dokumenti, i përgatitur në lidhje me reformën e kontabilitetit të sektorit publik, përfshin çështje rreth kuadrit rregullator për vlerësimin dhe inventarizimin e asetëve publike dhe përgatitjen e një regjistri të konsoliduar të asetëve në institucionet qendrore.

Tabela e mëposhtme paraqet statusin e arritjeve të treguesve të performancës për Shtyllën 4 “Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit”.

Tabela 5: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të shtyllës 4


Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2023	Vlera faktike 2023
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë¹³				
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.2 Kontabiliteti				
1	Numri shtesë i Institucioneve Buxhetore që kanë akses në SIFQ dhe arkivën elektronike (AE).	-	5 në SIFQ, 197 në AE	5 në SIFQ, 197 në AE
2	Prodhimi i kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor bazuar në SNKSP sipas planit.	-	Koncept dokumenti i përgatitur	Koncept dokumenti i përgatitur
4	Përqindja e kontabilitistëve të qeverisë që kanë përfunduar trajnimin SNKSP	-	40%	40%
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.3 Prokurimi Publik¹⁴				
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.4 Menaxhimi i Borxhit				
1	Plani Vjetor i Huamarrjes dhe Raporti i Monitorimit i SMB-së i përgatitur dhe publikuar	-	Dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të MF-së	PVH për 2024 dhe raporti i monitorimit të SMB përgatitur dhe publikuar
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.5 Menaxhimi i Likuiditetit				
1	Norma e saktësisë së parashikimit mujor të likuiditetit	88% (2022)	88%	88%
Objektivi Specifik (Komponenti) 4.6 Menaxhimi i Aseteve				
1	Krijimi i kuadrit të duhur rregullator për vlerësimin dhe inventarizimin e asetëve publike.	-	Koncept dokumenti i përgatitur	Koncept dokumenti i përgatitur
2	Përgatitja e një regjistri të konsoliduar të asetëve në institucionet qendrore, në nivel njësie kontrolluese.	-	Koncept dokumenti i përgatitur	Koncept dokumenti i përgatitur

Është bërë progres i kënaqshëm drejt përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023. 57.14% janë përfunduar dhe 42.86% janë në rrugën e duhur.

¹³ Për komponentin 4.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë, asnjë vlerë e synuar nuk janë vendosur për 2023.

¹⁴ Për komponentin 4.3 Prokurimi Publik, asnjë vlerë e synuar nuk janë vendosur për 2023.

Grafiku 9: Statusi për vitin 2023 të aktiviteteve në Shtyllën 4



Progresi i komponentëve (Objektivave Specifik) bërë gjatë vitit 2023

Objektivi Specifik 4.1 Llogaritë Kombëtare të Qeverisë

Edhe pse për vitin 2023 nuk kishte objektiva lidhur me "Llogaritë Kombëtare të Qeverisë", puna është bërë dhe ecuria është si më poshtë. Shqipëria ka bërë përpjekje për të përmirësuar të dhënat e Statistikave Financiare të Qeverisë (SFQ) dhe të Procedurave të Deficitit të Tejkualuar (PDT) në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive (SELL) 2010, Manualin mbi Deficitin dhe Borxhin Qeveritar (MDBQ) dhe udhëzime shtesë. Përpilimi i këtyre statistikave përfshin bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Institutit Shqiptar të Statistikave (INSTAT), Ministrisë së Financave (MF) dhe Bankës së Shqipërisë (BSH).

INSTAT, si koordinator i Sistemit Kombëtar të Statistikave, është përgjegjës për bashkërendimin dhe transmetimin e tabelave "Statistikat Financiare të Qeverisë" dhe "Procedurat e Deficitit të Tejkualuar" në Eurostat. Një grup pune midis INSTAT, BSH dhe MF është përgjegjës për përpilimin e këtyre statistikave. Grupi i punës ka marrë asistencë nga ekspertë të jashtëm nga Eurostat dhe FMN për të rritur cilësinë e këtyre statistikave. INSTAT mori mbështetje nga granti IPA 2019 për Projektin Statistikor 1.1 - Statistikat financiare të qeverisë dhe procedura e deficitit të tejkualuar, që kishte synim përmirësimin e raportimit të këtyre statistikave në Eurostat. Të gjitha përmirësimet e bëra gjatë zbatimit të këtij granti janë raportuar në Eurostat. Ky projekt përfundoi në dhjetor 2023. Që nga tetori 2014, INSTAT, në bashkëpunim me BSH, i ka transmetuar rregullisht Eurostat-it tabelat e PDT-së dy herë në vit. Transmetimi i fundit mbulon periudhën 2010-2023 për sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme, duke përfshirë njësitë buxhetore dhe jashtëbuxhetore. INSTAT ka përpiluar dhe transmetuar pjesërisht "Aneksin 3 - Pyetësor në lidhje me tabelat e PDT" në Eurostat, si dhe një draft inventar të PDT-së që përshkruan burimet e të dhënave dhe metodat e përdorura për përpilimin e statistikave SFQ dhe PDT në Shqipëri. Aktualisht, tabelat PDT i transmetohen Eurostatit me statusin "jo për botim".

INSTAT publikon rregullisht listën e njësive në sektorin e qeverisjes së përgjithshme, duke përfshirë korporatat financiare publike dhe korporatat jo financiare publike, sipas metodologjisë SELL 2010.

Duke përdorur AIGCS, INSTAT dhe BSH përpiluan dhe raportuan në Eurostat të dhëna për llogaritë jofinanciare dhe financiare për sektorin e qeverisë së përgjithshme. INSTAT ka përmirësuar të dhënat e SFQ në lidhje me klasifikimin e njësive brenda sektorit të qeverisjes së përgjithshme, mbulimin e burimeve të të dhënave dhe klasifikimin e llogarive të qeverisë në kodet SELL. Grupi i punës vazhdon të punojë për përmirësimin e të dhënave të SFQ dhe PDT për t'u përafëruar me metodologjinë SELL 2010 dhe Manualin për Deficitin dhe Borxhin Qeveritar. Aktualisht këto të dhëna i transmetohen Eurostatit me statusin "jo për publikim".

Objektivi Specifik 4.2 Kontabiliteti

Treguesit e Performancës

Sistemi i SIFQ mbetet instrumenti kryesor për kontrollin dhe monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pesë institucione të reja buxhetore kanë marrë akses të drejtpërdrejtë në sistemin SIFQ, ndërsa një numër shtesë prej 197 institucionesh të reja janë të lidhura me Arkivin Elektronik. Përqindja e buxhetit të zbatuar dhe monitoruar drejtpërdrejt në SIFQ është rritur në 83%. Në vitin 2023 përdorimi i arkivit elektronik (portali web) është zgjeruar, duke përfshirë 197 institucione të reja duke e çuar atë në 642 institucione gjithsej.

Përgatitja e fazës së dytë të reformave të Kontabilitetit dhe SNKSP është në rrugën e duhur me koncept dokumentet e përgatitura për zhvillimin e kuadrit ligjor dhe është siguruar mbështetja e partnerëve të zhvillimit me Bankën Botërore dhe SECO. Objektivi përfundimtar i reformës është përgatitja e pasqyrave financiare të institucioneve të sektorit publik bazuar në SNKSP të përzgjedhura. Pas finalizimit të fazës së parë të projektit të kontabilitetit të sektorit publik në dhjetor 2022, gjatë vitit 2023 është përgatitur dhe diskutuar me Bankën Botërore dhe SECO koncepti i fazës 2 të projektit për zbatimin e metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik. Një objektivi kryesor i kësaj faze të dytë është hartimi dhe miratimi i ligjit të kontabilitetit të sektorit publik dhe akteve të tjera nënligjore, bazuar në SNKSP sipas planit. Kjo fazë e dytë do të fillojë në vitin 2024.

Si pjesë e reformave të vazhdueshme të kontabilitetit, kontabilistët e qeverisë vazhduan të ndjekin trajnimet e SNKSP. Deri në fund të vitit 2023, 40% e kontabilistëve të qeverisë kanë përfunduar trajnimin SNKSP në përputhje me planin. Gjatë fazës së parë të projektit SNKSP, një nga objektivat kryesore ishte ngritja e kapaciteteve të kontabilistëve të sektorit publik në institucionet e sektorit publik. Në këtë drejtim, janë zhvilluar disa aktivitete, si p.sh.: pilotimi dhe prezantimi i një kursi trajnimi për trajnerë dhe kurse pasuese SNKSP për kontabilistët e qeverisë. Gjatë vitit 2023, DHMFKK në bashkëpunim me ASPA, organizuan disa trajnime në lidhje me kontabilitetin e sektorit publik dhe menaxhimin e aseteve me zyrtarë të qeverisë. Menaxhimi i mëtejshëm i ndryshimeve dhe ngritja e kapaciteteve parashikohet në fazën e dytë të reformave të kontabilitetit të mbështetur nga Banka Botërore: (i) Zhvillimi i programit të trajnimit dhe ofrimi i trajnimeve për auditues (auditimi i brendshëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit) mbi udhëzimet e reja të kontabilitetit, proceset e brendshme, bilancet e hapura dhe çështjet përkatëse të auditimit. (ii) Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi për Thesarin dhe institucionet buxhetore për të gjitha aspektet e mësipërme (mund të përkufizohen si aktivitete të veçanta ose të integruara në secilin element). (iii) Rritja e ndërgjegjësimit, evente të nivelit të lartë dhe aktivitete të tjera të menaxhimit të ndryshimeve.

Masat dhe aktivitetet

Gjatë vitit 2023, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka qenë në rrugën e duhur lidhur me aktivitetin për rritjen e aksesit dhe shfrytëzimit të SIFQ. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2023 u zgjerua me 197 institucione të reja buxhetore përdorimi i arkivit elektronik (portali web), i cili shërben për dërgimin elektronik të dokumentacionit justifikues të skanuar dhe firmosur elektronikisht nga institucioni i transaksioneve buxhetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në degët e Thesarit, duke e çuar numrin e përgjithshëm të institucioneve në 642.

Objektivi Specifik 4.3 Prokurimi Publik

Treguesit e Performancës

Megjithëse nuk është vendosur një vlerë e synuar për treguesit e performancës për vitin 2023, progres ka patur. Për sa i përket përdorimit të kriterëve të fituesit “Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto” (kriteret MEAT bazuar në kosto), për procedurat e prokurimit publik në vitin 2023, vlera e kontratave të dhëna në bazë të koston (MEAT) në lidhje me fondin total të akorduar ishte 20.33% në krahasim me vitin 2022 ku kjo vlerë ishte 33.92%. Kjo vlerë më e ulët është shkaktuar nga një rënie e ndjeshme e procedurave që lidhen me procesin e rindërtimit, procedura në të cilat kriteri i vetëm i vlerësimit ishte "Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto".

Masat dhe aktivitetet

Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit kanë vijuar mirë gjatë vitit 2023 me VKM 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në proces ndryshimi. Sapo të miratohen këto ndryshime, do të vazhdojë procesi i miratimit të udhëzimeve përkatëse, duke përfshirë udhëzimin MEAT.

Gjithashtu projektimi dhe zbatimi i prokurimit publik të gjelbër (PPGj) ka përparuar me miratimin dhe publikimin¹⁵ e udhëzuesit dhe metodologjisë për zbatimin e kriterëve të prokurimit të gjelbër/efiçencës së energjisë dhe hartimin e metodologjisë “Për Zbatimin e Prokurimit Publik të Gjelbër në Shqipëri”. Metodologjia PPGj është hartuar me ndihmën e Bankës Botërore dhe bazohet në kuadrin ligjor të BE-së.

APP ka hartuar dhe ka ofruar trajnime për prokurimin e gjelbër/efiçencën e energjisë për profesionistët e prokurimit. Në bashkëpunim me Bankën Botërore, APP ka përgatitur materialet e nevojshme paraprake për trajnimet e ardhshme për prokurimin e gjelbër, të cilat janë planifikuar të zhvillohen në vitin 2024. Këto trajnime do të mbulojnë tema të tilla si koncepti i PPGj-së dhe tendencat dhe praktikatat ndërkombëtare, detajet e planifikimit dhe hartimit të prokurimeve individuale të gjelbra, si dhe shtyllat e reformës efektive të prokurimit për PPGj në nivel institucional dhe kombëtar, praktikatat e mira ndërkombëtare dhe përdorimi i PPGj në Shqipëri. **Gjatë vitit 2023 APP ka nisur punën për rishikimin dhe ndryshimin e kuadrit rregullator.** Gjatë vitit 2023 APP ka nisur punën për rishikimin dhe amendimin e ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili do të pasohet nga rishikimi edhe i akteve nënligjore për sa i përket prokurimit. Në këtë drejtim gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, APP-ja u angazhua maksimalisht në procesin e hartimit të amendimeve ligjore të LPP-së, miratimi i të cilave do të pasohet me hartimin e VKM-ve të reja, si VKM-ja për pragjet, dhe amendimi i VKM-së ekzistuese për prokurimin social dhe VKM-të për rregullat e prokurimit.

Objektivi Specifik 4.4 Menaxhimi i Borxhit

Treguesit e Performancës

Me zhvillimin dhe publikimin e Planit Vjetor të Huamarrjes 2024 dhe Raportit të Monitorimit të SMB 2022, të gjitha objektivat e TP-ve janë arritur për vitin 2023. Raporti i Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit është përgatit nga Ministria e Financave në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë

¹⁵ <https://app.gov.al/legjisllacioni/prokurimi-publik/udherrefyses/> Udhëzimi “Për Zbatimin e Prokurimit Publik të Gjelbër në Procedurat e Prokurimit Publik”

shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Raporti iu dorëzua Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat dhe është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave¹⁶. Raporti monitorues paraqet një analizë mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit për vitin e kaluar. Publikimi i këtij raporti shërben si një hap pozitiv drejt rritjes së transparencës ndaj publikut të gjerë si dhe intensifikimit të komunikimit me investitorët apo palët e treta të interesuara. Plani vjetor i huamarrjes për vitin 2024 është përgatitur në fund të vitit 2023 dhe është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave¹⁷. Plani me informacionin përkatës për planin e emetimeve të letrave me vlerë të qeverisë në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar përgjatë vitit me riblerje bruto, paraqet burimet e financimit.

Masat dhe aktivitetet

Janë përfunduar të dyja aktivitetet që kanë lidhje me forcimin e raportimit të menaxhimit të borxhit dhe marrëdhënieve me investitorët. Plani vjetor i huamarrjes për vitin 2024 është përgatitur në fund të vitit 2023 dhe është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave. Dokumenti ndjek praktikën ndërkombëtare të shëndosha, duke qenë konciz dhe duke identifikuar qartë nevojat vjetore të financimit bruto, si dhe mënyrën se si planifikohet të financohet. Për huamarrjen e brendshme, ai përcakton afatet e letrave me vlerë dhe shumën e vlerësuar të huamarrjes sipas instrumenteve. Kalendarin e emetimeve të brendshme është përfshirë në PVH. Për sa i përket projeksioneve të huamarrjes së jashtme, plani tregon qartë vëllimet e parashikuara për financimin e projekteve nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe operacionet e mbështetjes buxhetore me subjektet dypalëshe dhe shumëpalëshe. **Raporti i Monitorimit për SMB për vitin 2022, është përgatitur dhe publikuar në faqen e MF-së¹⁸ në Mars 2023.** Raporti i Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit është përgatitur në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky raport monitorimi përgatitet nga Ministria e Financave dhe i dërgohet Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave. Ky raport paraqet një analizë mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit për vitin e kaluar. Publikimi i këtij raporti do të shërbejë si një hap pozitiv drejt rritjes së transparencës ndaj publikut të gjerë si dhe intensifikimit të komunikimit me investitorët apo palët e treta të interesuara.

Objektivi Specifik 4.5 Menaxhimi i Likuiditetit

Treguesit e Performancës

Sa i përket Menaxhimit të Likuiditetit kishte vetëm një tregues të performancës për vitin 2023, që u arrit sipas planit. Parashikimi mujor i likuiditetit është një tregues që varet nga ecuria e shpenzimeve dhe të ardhurave mujore. Duke qenë se gjatë vitit 2023, mbledhja e të ardhurave dhe realizimi i shpenzimeve në disa muaj ka qenë më i lartë ose më i ulët se parashikimet e bëra, për rrjedhojë ka patur ndikim në parashikimin mujor të likuiditetit dhe ka mbetur mesatarisht 88%.

¹⁶ https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Monitoring-Report_Year-2022_English-Version.pdf

¹⁷ Plani Vjetor i Huamarrjes publikuar në https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/APB_2023_Final3.pdf

¹⁸ https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Monitoring-Report_Year-2022_English-Version.pdf

Objektivi Specifik 4.6 Menaxhimi i Aseteve

Treguesit e Performancës

Në fushën e menaxhimit të asetëve, janë ndërmarrë hapa për krijimin e kuadrit të përshtatshëm rregullator për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurive publike dhe për përgatitjen e një regjistri të konsoliduar të asetëve në institucionet qendrore, në nivel njësie kontrolluese. Objektivi strategjik përfundimtar i reformës është përgatitja e pasqyrave financiare të institucioneve të sektorit publik bazuar në SNKSP të përzgjedhura. Pas finalizimit të fazës së parë të projektit të kontabilitetit të sektorit publik në dhjetor 2022, gjatë vitit 2023 është hartuar koncepti i projektit për zbatimin e metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik, 0 i diskutuar me Bankën Botërore dhe SECO. Një objektivi kryesor i kësaj faze të dytë të projektit është miratimi i ligjit të kontabilitetit të sektorit publik dhe akteve të tjera nënligjore, bazuar në SNKSP, sipas planit. Pjesë e këtij kuadri rregullator të përditësuar është edhe metodologjia në lidhje me inventarizimin dhe vlerësimin e asetëve të sektorit publik. Gjithashtu, me mbështetjen e konsulentëve të projektit, në institucionet qendrore në nivel njësie kontrolluese do të përgatitet një regjistër i konsoliduar i asetëve. Kjo fazë e dytë do të nisë gjatë vitit 2024.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nuk ka sfida kryesore, pasi të gjitha aktivitetet janë të përfunduara dhe në rrugën e duhur.

3.5 Progresi në Shtyllën 5 “Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik”

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik është profesionalizuar më tej në të gjitha Institucionet Buxhetore në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat e integritetit në BE. Përgjatë shtyllës 5, 70% e objektivave të TP-ve janë arritur deri në fund të vitit 2023, 10% janë arritur pjesërisht dhe 20% e objektivave të TP-ve nuk janë arritur ende. Tabela e mëposhtme paraqet statusin e arritjes së treguesve të performancës për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik të Shtyllës 5.


Tabela 6: Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara të Shtyllës 5

Treguesi		Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar 2023	Vlera fakt 2023
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli				
1	Përqindja e Institucioneve Publike që përmbushin kërkesat e MFK-së.	69% (2022)	70%	72%
2	Përqindja e institucioneve publike që kanë të vendosur mekanizma adekuat të llogaridhënies menaxheriale.	68% (2022)	70%	73%
3	Ligji dhe aktet nënligjore të MFK-së janë ndryshuar dhe miratuar.	ND	Ligji i MFK-së, manuali i MFK-së dhe udhëzimi për deklarimin dhe raportimin për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të miratuar	Amendimet e Ligjit të MFK miratuar dhe kanë hyrë fuqi
4	Përqindja e institucioneve publike që kanë adoptuar të gjitha mjetet e menaxhimit të riskut.	68% (2022)	70%	73%
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.2 Auditimi i Brendshëm				
1	Numri i institucioneve publike që mbulohen nga auditimet e brendshme vjetore.	136	138	142

2	Numri i institucioneve publike që kanë një komitet funksional auditimi.	6	7	6
3	Përqindja e audituesve të brendshëm aktivë që janë plotësisht të certifikuar ¹⁹ .	80%	88%	81%
4	Përqindja e njësive të auditimit të brendshëm që kanë krijuar dhe zbatuar PPSC në përputhje me standardet në fuqi.	52%	71%	86%
5	Përqindja e audituesve të brendshëm që përputhen me kërkesat e ZHVP	100%	100%	100%
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit²⁰				
Objektivi Specifik (Komponenti) 5.4 Menaxhimi i Fondeve të BE-së				
1	Hartohet dhe miratohet paketa për marrjen e besimit IPA-III.	-	Hartohet paketa për marrjen e besimit IPA-III	Hartuar paketa për marrjen e besimit IPA-III dhe dorëzuar te KE

Progres i kënaqshëm është bërë edhe në drejtim të zbatimit dhe përfundimit të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023. Shumica prej 75% e aktiviteteve ishin në rrugën e duhur ose të përfunduara, ndërsa pjesa e mbetur prej 25% e aktiviteteve u vlerësuan si pjesërisht në rrugën e duhur.

Grafiku 10: Statusi për vitin 2023 të aktiviteteve në Shtyllën 5



Progresi i komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2023

Objektivi Specifik 5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Treguesit e Performancës

Objektivat e vendosura në planin e veprimit të MFP-së 2023-2026 për (i) përmbushjen e kërkesave të MFK-së, (ii) krijimin e mekanizmave adekuate të llogaridhënies menaxheriale dhe (iii) miratimin e mjeteve të menaxhimit të riskut janë tejkaluar disi.

¹⁹ Të gjithë audituesit e brendshëm duhet të çertifikohen brenda 3 viteve, sipas ligjit.

²⁰ Për objektivin specifik (Komponenti) 5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit Kundër Mashtrimit, nuk janë vendosur objektiva për vitin 2023

Përqindja e Institucioneve Publike që përmbushin kërkesat e MFK-së është 72% kundrejt një objektivi prej 70%. Fokusi kryesor ishte përmirësimi i funksionalitetit të sistemit të MFK-së nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike dhe vlerësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm dhe progresit të sistemit të kontrollit të brendshëm duke inkurajuar angazhimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me rëndësinë strategjike dhe operacionale të zbatimit të instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nga analiza e detajuar e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm, rezultoi se sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2023 është pjesërisht efektiv. Komponentët e vlerësimit të mjedisit të kontrollit dhe aktiviteteve të kontrollit vazhdojnë të tregojnë një vlerësim më të kënaqshëm. Konkretisht, zbatimi i vlerësimeve të cilësisë së MFK-së në institucionet publike dhe ofrimi i asistencës teknike ka rritur ndërgjegjësimin e drejtuesve dhe stafit për njohjen dhe zbatimin e instrumenteve të MFK-së. Rekomandimet e dhëna në raportet e vlerësimit kanë shërbyer si pikënisje për hartimin e planeve të veprimit në nivelin e institucioneve publike. Këto plane theksojnë masat për adresimin e mangësive dhe ndjekjen e vazhdueshme të tyre dhe kontribuojnë në përmirësimin e mekanizmave të monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Përqindja e institucioneve publike që kanë mekanizma adekuate të llogaridhënies manaxheriale është rritur në 73% në vitin 2023 kundrejt objektivi 70%. Këto institucione kanë miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë, natyrën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre. Gjithashtu, këto institucione kanë përcaktuar deklaratat e misionit dhe objektivat e tyre strategjike dhe operacionale, pjesë e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), duke krijuar një lidhje organike midis këtyre prioriteteve dhe objektivave të performancës. Në hartimin e PBA-së janë të përfshirë të gjithë drejtuesit e programit, të cilët analizojnë situatën dhe përcaktojnë, monitorojnë dhe raportojnë prioritetet dhe objektivat që duhen realizuar. Në të njëjtën kohë, vërehet një mungesë e raportimit të rregullt periodik dhe zbatimit të masave konkrete për adresimin e çështjeve që lidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm. Kjo tregon nevojën për hartimin e një sistemi procedurash për krijimin, zbatimin dhe raportimin periodik të standardeve tek drejtuesit apo strukturat e tjera të institucionit. Fokusi i kuadrit aktual të raportimit mbetet në ofrimin e informacionit për performancën financiare, si raportet e monitorimit të buxhetit apo raportet mbi detyrimet financiare, dhe më pak në përgatitjen e raporteve periodike për ecurinë dhe statusin e zbatimit të objektivave të vendosura ose çështjeve që lidhen me sistemet e kontrollit të brendshëm. Një mekanizëm tjetër i rëndësishëm për funksionimin e një sistemi efektiv të përgjegjësisë manaxheriale është përdorimi i procedurave të rregullta për delegimin e detyrave dhe përgjegjësisë. Ky element është zbatuar pak dhe vlerësohet si i pakënaqshëm. MF-ja mbështet institucionet në zbatimin e instrumenteve të llogaridhënies manaxheriale, nëpërmjet kuadrit rregullator apo asistencës teknike, si dhe nëpërmjet rekomandimeve të dhëna gjatë vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe trajnimeve. Mangësitë e evidentuara në këtë aspekt lidhen kryesisht me mungesën e ndërgjegjësimit për të kuptuar rëndësinë e tij si dhe me përcaktimin e qartë të termave, rregullave dhe procedurave që duhen ndjekur në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike.

Ministria e Financave (DHMFKK) vazhdoi të përmirësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për MFK-në. Ndryshimet për Ligjin nr. 10296, datë 07.08.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, janë miratuar me Ligjin 14/2023. Manuali i MFK-së është ndryshuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 4, datë 26.01.2024 dhe Udhëzimi për paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike është rishikuar me udhëzimin nr. 2, datë 26.01.2024.

Sistemet adekuate për menaxhimin e riskut janë një tjetër element i rëndësishëm i sistemit të MFK-së. 73% (kundrejt një objektivi prej 70%) të institucioneve publike kanë miratuar të gjitha mjetet e menaxhimit të riskut në vitin 2023. Vlen të theksohet angazhimi i institucioneve në

përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm ku identifikohen objektivat dhe prioritetet e institucionit së bashku me programet të cilave u përkasin këto objektiva. Nga analiza e kryer duket qartë se një pjesë e institucioneve (drejtoritë dhe departamentet) hartojnë objektivat e tyre operacionale duke i vendosur ato në përputhje me objektivat strategjike dhe politikat kombëtare. Realizimi i këtij procesi në tërësi, duke krijuar një lidhje të qartë mes qëllimit të politikave, objektivave strategjike dhe operacionale si dhe buxhetit të caktuar për realizimin e tyre, shërben si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Në përgjithësi, mosfunksionimi i këtij komponenti në nivelin e kërkuar vjen si pasojë e mos përmbylljes së procesit të strukturuar të përcaktimit të objektivave në plane konkrete veprimi për përmbushjen e tyre nga të gjithë punonjësit sipas përgjegjësisë të caktuara. Një situatë pozitive e menaxhimit të riskut vazhdon të paraqitet në disa nga ministritë e linjës, institucione të pavarura apo bashki që janë mbështetur nga Projekti i Financave Vendore dhe për të cilat janë krijuar mekanizma të menaxhimit të riskut, duke përfshirë ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut, rregulloret për funksionimin e tij ose identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e risqeve për disa nga proceset kryesore.

Masat dhe aktivitetet

Ministria e Financave (DHMFKK) vazhdoi të përmirësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për MFK-në. Ndryshimet për Ligjin nr. 10296, datë 07.08.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, janë miratuar me Ligjin 14/2023. Ndërkohë, aktiviteti i rishikimit dhe përditësimit të akteve nënligjore dhe përmirësimit të mëtejshëm të manualit të MFK-së është në rrugën e duhur. Është punuar për hartimin e ndryshimeve në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i cili është rishikuar me Urdhërin Nr.4, datë 26.01.2024. Udhëzimi “Për paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike” është rishikuar me udhëzimin nr.2, datë 26.01.2024.

Objektivi Specifik 5.2 Auditimi i Brendshëm

Treguesit e Performancës

Janë 142 (nga 138 të planifikuara) institucione publike që janë mbuluar nga auditimet e brendshme vjetore në vitin 2023 (Neni 10 i Ligjit për AB 114/2015, i ndryshuar). 136 institucione publike kanë krijuar njësi të AB (Auditim të Brendshëm) deri në fund të vitit 2022 si funksion të përhershëm, duke i raportuar drejtpërdrejt Bordit ose Drejtuesit të Institucionit. Përveç kësaj, 6 institucione të tjera publike kanë kontraktuar shërbimin e AB-së përmes një marrëveshjeje dypalëshe ndërmjet dy subjekteve publike.

Numri i Komiteteve funksionale të Auditimit vazhdon të jetë i njëjtë në vitin 2023, ndërkohë në disa ministri Komiteti i Auditimit është krijuar së fundmi dhe në disa të tjera duhet të rithemelohej. Megjithatë, këto 6 Komitete Auditimi mbulojnë çështjet e auditimit për një numër më të madh të institucioneve publike (përfshirë agjencitë në varësi të ministrive të linjës). Arsyeja kryesore që nuk ka rritje të numrit të Komiteteve të Auditimit lidhet me ndryshimet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, të cilat pasqyrohen në Ligjin e AB-së dhe akte të tjera nënligjore. Aktualisht Vendimi i Këshillit të Ministrave për Komitetet e Auditimit është duke iu nënshtruar procesit të amendimit.

81% (nga 88% e planifikuar) e auditorëve të brendshëm aktivë janë certifikuar plotësisht gjatë vitit 2023. Në qershor 2023, u përfundua me sukses sesioni i fundit i Çertifikimit të AB 2022 - 2023 nga 80 auditues të brendshëm. Aktualisht nga 441 praktikues të auditimit të brendshëm në institucionet publike, 355 auditues të brendshëm janë të certifikuar dhe 86 të tjerë pritet të marrin pjesë në sesionin

e ardhshëm të certifikimit. Normalisht, të gjithë audituesit e brendshëm duhet të certifikohen brenda 3 viteve sipas ligjit të AB 114/2015, të ndryshuar.

86% (nga 71% e planifikuar) e njësive të auditimit të brendshëm kanë krijuar dhe zbatuar PPSC në përputhje me standardet në fuqi. Sipas SNAB, të gjitha njësitë e AB duhet të vlerësohen nga një organ i jashtëm (aktualisht DHAB) për përputhjen e tyre me kërkesat e Standardeve të AB dhe ligjit të AB. Aktualisht, DHAB-ja ka mbuluar vlerësimin e jashtëm për 117 njësi të AB, nga 136 të krijuara. Njësitë e tjera të AB-ve janë krijuar në më pak se 5 vjet, ndaj do të jenë në fokus për vlerësimet e ardhshme. DHAB ka rikryer Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë për herë të dytë në më pak se 5 vjet për ato njësi që rezultuan me performancë shumë të ulët dhe të vlerësuara me Opinion "të kuq", për të ndjekur ecurinë dhe përmirësimin e tyre.

100% e auditorëve të brendshëm përputhen me kërkesat e ZhVP Të gjithë praktikuesit e auditimit të brendshëm në sektorin publik janë trajnuar për më shumë se 40 orë trajnime me prezencë fizike gjatë vitit.

Masat dhe aktivitetet

Një arritje e madhe në vitin 2023 ka qenë miratimi i Ligjit nr. 12, datë 02.02.2023 “Për disa amendime dhe ndryshime në ligjin e auditimit të brendshëm nr.114, datë 22.12.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, është bërë përparim i dukshëm në zhvillimin e mjeteve dhe mekanizmave për kontraktimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm ose krijimin e shërbimeve të përbashkëta të auditimit të brendshëm. Neni 10 i ligjit për AB, të ndryshuar, tanimë ofron në mënyrë të qartë mundësi të aksesueshme për institucionet publike të cilave u mungon një ekip i auditimit të brendshëm për t'i përdorur këto mekanizma në mënyrë efektive. Ky përditësim legjislativ, i cili ka hyrë në fuqi nga 8 marsi 2023, shënon një hap vendimtar përpara në rritjen e qeverisjes dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike në të gjithë Shqipërinë. Duke mundësuar aksesin në shërbimet e auditimit të brendshëm të kontraktuara ose ato të përbashkëta, ligji i amenduar synon të thjeshtojë veprimet, të përmirësojë transparencën dhe të rrisë standardet e mbikëqyrjes financiare brenda sektorit publik.

Profesionalizimi i praktikave thelbësore të auditimit të brendshëm përmes zhvillimit të udhëzimeve dhe ofrimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve është në rrugën e duhur. Çdo vit Ministri i Financave miraton Programin Vjetor për Trajnimin e Vazhdueshëm të Auditorëve të Brendshëm, i cili zbatohet nga DHAB.

Objektivi Specifik 5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit

Masat dhe aktivitetet

Hartimi dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit 2025-2027 për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së është në rrugën e duhur. Kjo strategji për të mbrojtur interesat financiare të BE-së, siç përshkruhet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026, nënkupton një iniciativë të rëndësishme nën mbikqyrjen e Ministrisë së Financave. Me Urdhër nr. 127, datë 15.04.2022, krijimi i një grupi pune të dedikuar nënvizon angazhimin e Shqipërisë për të luftuar mashtrimin dhe për të garantuar integritetin në menaxhimin e fondeve të BE-së, veçanërisht ato që lidhen me programet IPA dhe IPARD. Kjo përpjekje strategjike përfshin bashkëpunim të ngushtë ndërmjet operatorëve dhe menaxherëve të fondeve të BE-së, krahas strukturave kyçe brenda rrjetit të raportimit të shërbimit “ShKKM/AFCOS”. Asistenca teknike e ofruar përmes projektit për Qeverisjen

e Mirë ka fuqizuar ekspertët e kontraktuar që të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në formulimin e strategjisë. Takimet e rregullta në Ministrinë e Financave kanë lehtësuar mbarëvajtjen e këtij dokumenti kritik, duke siguruar përafrimin me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së. Ndërkohë që strategjia evoluon, koordinimi i vazhdueshëm me ZEKM/OLAF nënvizon qëndrimin proaktiv të Shqipërisë në nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin financiar në institucionet publike.

Objektivi Specifik 5.4 Menaxhimi Fondeve të BE-së

Treguesit e Performancës

Për sa i përket menaxhimit të fondeve të BE-së, objektivi i treguesit të performancës 2023 është arritur. Të gjitha paketat e besimit të IPA III për Programet Vjetore të Veprimit IPA 2022 dhe tre Programet Operacionale (PO) janë zhvilluar dhe janë dorëzuar zyrtarisht nga ZKA te KE. Paketa e besimit e Programeve Vjetore të Veprimit IPA 2022 u dërgua në nëntor 2023 dhe u auditua në dhjetor 2023 nga DG NEAR. Besimi u dha pas raportit të tyre përfundimtar më 1 mars 2024. Për të tre programet operative, paketat e besimit u dërguan në maj 2024 dhe u audituan në qershor 2024. Pas auditimit, u dha besimi për tre PO-të pas raportit të tyre përfundimtar më 28 gusht 2024.

Masat dhe aktivitetet

Krijimi i kuadrit ligjor IPA III ka përfunduar me miratimin e VKM nr. 540, datë 20.09.2023. Ky shënon një hap të rëndësishëm në krijimin e kuadrit ligjor për IPA III në Shqipëri. Vendimi përshkruan strukturat dhe autoritetet përgjegjëse për menaxhimin indirekt të asistencës financiare në kuadër të programeve vjetore dhe shumëvjeçare të Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit (IPA III) për periudhën 2021-2027, pasi u dha në besim nga BE-ja te Republika e Shqipërisë. Në qendër të këtij kuadri është neni 14 “Mbrojtja e interesave financiare të BE-së”, kushtuar mbrojtjes së interesave financiare të BE-së, që detajon me përpikmëri dispozitat që synojnë garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe përdorimit efikas të fondeve të BE-së.

Zhvillimi dhe zbatimi i rregulloreve, procedurave për menaxhimin e IPA III dhe rritjen e kapaciteteve të strukturave të IPA III. Kuadri menaxhues dhe operacional për IPA III në Shqipëri është forcuar ndjeshëm nëpërmjet masave vendimtare të përcaktuara në VKM 540/2023. Kjo direktivë krijon zyrtarisht strukturat e menaxhimit përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të programeve të asistencës financiare të IPA III nga viti 2021 deri në vitin 2027. Për më tepër, janë ndërmarrë përpjekje rigorozë për të garantuar efikasitetin operacional dhe përputhshmërinë nëpërmjet zhvillimit dhe miratimit të Manualeve të Procedurave gjithëpërfshirëse. Këtu përfshihen manuale horizontale dhe specifike të miratuara nga Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA), si Manuali Horizontal i Procedurave, i sanksionuar me vendimin nr. 20186 më 6 nëntor 2023, për të siguruar njëtrajtshmëri dhe qëndrueshmëri në të gjitha strukturat IPA III. Gjatë kësaj periudhe, u zyrtarizuan edhe udhëzime specifike procedurale për organe të ndryshme kyçe, duke përfshirë Organin e Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar (ONMF/IBFM) sipas Urdhrit të ZKA-së nr. 19994 datë 1 nëntor 2023, Organi Kontabël (Fondi Kombëtar) me Urdhërin e ZKA nr. 20184 datë 06.11.2023, dhe Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (KKIPA) sipas Vendimit nr. 757/5 lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SASPAC më 31 tetor 2023. Njëkohësisht, është miratuar një qasje proaktive për ngritjen e kapaciteteve, ku të gjitha strukturat IPA III kryejnë vlerësime të plota të aftësive të tyre dhe identifikojnë boshllëqet e aftësive. Aktualisht, ZKA/ZMZKA, e mbështetur nga ekspertët të asistencës teknike, është në procesin e hartimit të një plani gjithëpërfshirës të zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, që synon të rrisë kompetencat e personelit në të gjitha njësitë IPA III, duke forcuar kështu gatishmërinë dhe efikasitetin institucional të Shqipërisë në menaxhimin e asistencës së para-aderimit të BE-së.

Për sa i përket përmirësimit të procedurave të rregullimit financiar dhe/ose rikuperimit për fondet e BE-së në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare dhe të IPA III, të gjitha aktivitetet e planifikuara janë pjesërisht në rrugën e duhur. Të gjitha aktivitetet fillimisht ishin planifikuar të nisnin brenda vitit 2023, por duke pasur parasysh se procesi i akreditimit zgjati më shumë se sa ishte parashikuar fillimisht, kontrata e Asistencës Teknike është nënshkruar më vonë. Nisur nga kjo, aktivitetet janë kërkuar dhe planifikuar të mbulohen nga projekti IPA “Mbështetje për Menaxhimin e Asistencës Financiare të BE-së në Shqipëri” (NEAR/TIA/2023/EA-RP/0136) gjatë vitit 2025.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm


Nuk kishte sfida kryesore, pasi të gjitha aktivitetet janë përfunduar ose në rrugën e duhur, përveç aktiviteteve që kontribuojnë në përmirësimin e rregullimeve financiare dhe/ose procedurave për rikuperimin e fondeve të BE-së, në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare dhe IPA III. Megjithatë, aktivitetet janë kërkuar dhe planifikuar të mbulohen nga projekti IPA “Mbështetje për Menaxhimin e Asistencës Financiare të BE-së në Shqipëri”.

3.6 Progresi në Shtyllën 6 “Mbikëqyrja e Jashtme”

Gjatë vitit 2023, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat vazhduan të forcojnë mekanizmin e mbikëqyrjes së jashtme. KLSH është angazhuar aktivisht në plotësimin e treguesve të performancës të cilët do të raportohen në vitet në vijim sipas planit të veprimit dhe pasaportës së treguesve. Në mënyrë të veçantë, përpjekjet janë të orientuara drejt një kontrolli efektiv të institucioneve publike, duke rritur mbulimin dhe standardet e auditimit për të siguruar mbikëqyrje të plotë të proceseve financiare dhe për të forcuar praktikatat e ndjekjes së auditimit të jashtëm, thelbësore për ruajtjen e llogaridhënies dhe transparencës në praktikatat e menaxhimit financiar (treguesit PEFA 30.1 dhe 30.2 dhe Treguesi SIGMA 4.3.1). Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat po përparon në mënyrë aktive drejt plotësimit të treguesit të PEFA 31, i cili vlerëson shqyrtimin legjislativ të raporteve të auditimit. Kjo nismë nënvizon përkushtimin e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën në mbikëqyrjen financiare. Për vitin 2023, nuk janë përcaktuar objektiva specifike në planin e veprimit të MFP-së.

75% e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023 janë në rrugën e duhur dhe 25% janë pjesërisht në rrugën e duhur, siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 11: Statusi për vitin 2023 të aktiviteteve në Shtyllën 6



Progresi i komponentëve (Objektivave Specifikë) bërë gjatë vitit 2023

Objektivi Specifik 6.1 Auditimi i Jashtëm

Masat dhe aktivitetet

KLSH vazhdoi punën për përmirësimin e kuadrit metodologjik ligjor, rregullator dhe fleksibël, dhe për zgjerimin e përdorimit të mjeteve të auditimit. Aktiviteti i përcaktimit të ndryshimeve në Ligjin nr. 154, datë 21.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për forcimin e mëtejshëm të pavarësisë dhe mandatit kushtetues të KLSH-së është pjesërisht në rrugën e duhur. Gjatë vitit 2023, KLSH ka nisur procedurat për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e ligjit.

Është bërë progres në profesionalizimin e raportimit dhe komunikimit në përputhje me strategjinë e komunikimit të KLSH-së dhe me parimet dhe standardet në fuqi. Për sa i përket përmirësimit të cilësisë së raporteve të auditimit të përshtatura sipas kërkesave të lexuesve të tij dhe përdorimit të zgjeruar të të gjitha mjeteve të komunikimit për të promovuar vazhdimisht rolin e KLSH-së, zhvillimet e fundit në praktikat globale përfshijnë rishikimin madhor në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) 140, të cilat kaluan nga sistemi i kontrollit të cilësisë në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Kjo solli nevojën për patjen e një sistemi të fortë dhe një qasje të bazuar në risk për menaxhimin e cilësisë së auditimit. Në përgjigje, gjatë vitit 2024, KLSH kreu Vlerësimin e Nevojave si një fazë paraprake për miratimin e Politikave të Menaxhimit të Cilësisë, duke synuar analizimin e politikave dhe procedurave ekzistuese dhe identifikimin e mundësive për përmirësim të mëtejshëm. KLSH miratoi gjithashtu Politikën e saj për Menaxhimin e Cilësisë, që përmbledh të gjitha politikat dhe procedurat përkatëse në lidhje me cilësinë e auditimit, duke përfshirë nevojat për të përmirësuar udhëzimet e nevojshme dhe/ose shtesë për të përmbushur standardet e menaxhimit të cilësisë. Kjo politikë është publikuar tashmë në faqen e KLSH-së. Për sa i përket zgjerimit të monitorimit, raportimit dhe komunikimit për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit nga të audituarit, KLSH verifikoi zbatimin e 4631 rekomandimeve (krahasuar me 3764 në 2022 dhe 1376 në 2021). Shkalla e zbatimit për vitin 2023 rezultoi të jetë 75%. Gjithashtu, në përputhje me qëllimet strategjike të KLSH-së, u hartuan sërish formularët e mbledhjes së të dhënave të përdorura për statusin e zbatimit të rekomandimeve nga secili departament. Kjo përmirësoi saktësinë e raportimit të KLSH-së. Gjatë vitit 2023, KLSH ka rishikuar edhe formatin e Raportit “Për ndjekjen e Rekomandimeve të Auditimit”. Gjithashtu, KLSH publikon rregullisht raportet e auditimit në faqen e internetit të KLSH-së dhe i paraqet ato në Kuvend.

Objektivi Specifik 6.2 Mbikëqyrja Parlamentare

Masat dhe aktivitetet

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat (KEF) ka punuar për profesionalizimin e strukturave mbështetëse të Komisionit duke përgatitur dhe nisur zbatimin e një plani zhvillimi. Aktiviteti që kontribuon në profesionalizimin e mëtejshëm të strukturave mbështetëse të KEF është në rrugën e duhur. Në përputhje me planin e veprimit, KEF ka bashkëpunuar me disa institucione ndërkombëtare. Me mbështetjen e “Fondacioni Westminster për Demokraci” (FWD), përfaqësuesit e KEF-it dhe të disa komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit të Shqipërisë u njohën me punën e kryer nga komisionet parlamentare përkatëse të parlamentit anglez dhe atij sllloq. Gjithashtu, Fondacioni FWD ofroi mbështetje për hartimin e metodologjisë së Rishikimit Post-Legjislativ dhe Vlerësimit të Parandalimit të Korrupsionit. Gjithashtu, Instituti Kombëtar Demokratik Amerikan (IKD) kontribuoi në vlerësimin e rolit të Kuvendit në luftën kundër korrupsionit, me fokus të veçantë në rritjen e bashkëpunimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit. KEF, administrata e Kuvendit dhe ekspertë të IKD-së

punuan për konceptin për krijimin e Nënkomitetit të Auditimit Publik. Me mbështetjen e IKD-së, përfaqësues të mazhorancës dhe opozitës në KEF morën pjesë në Samitin e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH) me fokus qeverisjen e hapur në epokën dixhitale, rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës dhe forcimin e demokracisë. Në samit u shkëmbyen ide për forcimin e rolit të Kuvendit në mbikëqyrjen e qeverisë, dixhitalizimin e proceseve të punës dhe rolin e shoqërisë civile. Përfaqësues të KEF-it dhe stafit të tij mbështetës morën pjesë në një konferencë të organizuar nga Banka Botërore në lidhje me rregullat fiskale dhe këshillat fiskalë në Ballkanin Perëndimor. Objektivi i konferencës ishte hartimi dhe shkëmbimi i njohurive mbi rregullat fiskale dhe sfidat operative për krijimin dhe mbajtjen e këshillave fiskalë efektivë. Nënkomiteti për Zhvillimin e Qëndrueshëm ka bashkëpunuar me PKBZh/UNDP për hartimin e metodologjisë të matjes së OZHQ-ve dhe me BNP-në (Bashkimi Ndër Parlamentar) për forcimin e aftësive të Nënkomitetit.

Sfidat kryesore dhe hapat e mëtejshëm

Nuk ka sfida kryesore të hasura gjatë vitit 2023.

4. Risqet dhe hapat për adresimin e tyre

Janë materializuar ose janë identifikuar disa risqe dhe sfida që ndikojnë në zbatimin e planit të veprimit. Një nga risqet kryesore që është materializuar ose është identifikuar gjatë zbatimit të planit të veprimit në vitin 2023 është numri i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore të kualifikuara, kapaciteti i ulët i burimeve njerëzore ekzistuese dhe lëvizja e stafit. Risqe të tjera përfshijnë kufizimet në disponueshmërinë e burimeve buxhetore për zbatimin e aktiviteteve të reformave, mungesën e koordinimit dhe angazhimit të palëve të interesuara, vonesat në prokurimet dhe vonesat në hartimin dhe miratimin e ndryshimeve legislative.

Me qëllim menaxhimit në mënyrë efektive të reformave si dhe bazuar në përvojën e periudhës 2014-2022, risqet që ndikojnë negativisht zbatimin e planit të veprimit po menaxhohen në mënyrë aktive.

Shtylla 1 “Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut Fiskal”. Për Programimin makroekonomik dhe monitorimin e riskut fiskal, rekrutimi i stafit me kualifikim të lartë nuk ka mundur të përfundojë ende. Trajnimet e stafit ekzistues dhe forcimi i kapaciteteve janë një proces i vazhdueshëm, ndërsa rekrutimi për staf të ri duhet të bëhet publik në faqen zyrtare të nëpunësve civilë, e cila operohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP).

Shtylla 2 “Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent”. Sa i përket Menaxhimit të Investimeve Publike, zbatimi adekuat i rregulloreve të reja të MIP është vonuar për shkak të boshllëqeve në kapacitetet e burimeve njerëzore. Masat e marra dhe ato të planifikuara për të adresuar këtë çështje janë vlerësimi i nevojave për burime njerëzore, përgatitja dhe ekzekutimi i një plani rekrutimi (në vitin 2024) dhe vazhdimi i ofrimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve. Për më tepër, VKM 887/2022 u amendua në vitin 2024 për të adresuar një numër boshllëqesh. Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i plotë i Sistemit të ri të Menaxhimit të Buxhetit Vendor nga bashkitë u pengua nga kufizimet e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Masat e marra për zbutjen e këtij risku përfshijnë ofrimin e trajnimeve rajonale me të gjithë drejtorët e buxhetit dhe disa nga drejtuesit e programeve. Në vitin 2024 është planifikuar të kryhen trajnime për të gjitha fazat e proceseve buxhetore.

Shtylla 3 “Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave”. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve raporton se një çështje kritike ishte lëvizja e stafit. Stafit i kualifikuar është larguar për angazhime të tjera jashtë DPT ose drejt vendeve të BE-së. Gjithashtu, ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë i vështirë rekrutimi i personelit të ri me njohuri të mira në teknologjinë e informacionit, statistikën, etj. Proceset e tenderimit që zgjasin për një periudhë të gjatë, si për sektorin e TI-së, ashtu edhe për funksione të tjera mbështetëse, krijojnë vështirësi në proceset e punës së administratës tatimore. Gjatë vitit 2023 janë ndërmarrë disa masa pas materializimit të riskut, siç janë: (i) shpërblym financiar i të gjithë stafit të angazhuar në procesin e skanimit të situatës së Shqipërisë në lidhje me anëtarësimin në BE; (ii) rritja e pagave për administratën publike, fillimisht për drejtuesit e lartë dhe më pas për t'u shtrirë në çdo nivel të hierarkisë. Gjatë vitit 2024 do të vijojë procesi i rritjes së pagave për administratën publike. Lidhur me zhvillimin e Menaxhimit të Taksës së Pasurisë, u vu re një nivel i ulët i angazhimit të bashkive në përdorimin e Sistemit TI të Kadastrës Fiskale dhe mungesë angazhimi nga aktorë të tjerë të rëndësishëm. Gjatë vitit 2023 janë ndërmarrë disa masa pas materializimit të risqeve. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë ka: (i) kryer trajnime të stafit të NJQV-ve; (ii) organizuar takime me përfaqësues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për të dhënat e pronësisë dhe me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në lidhje me dorëzimin e Sistemit TI të Kadastrës Fiskale (FCIS). Gjatë vitit 2024, AKSHI ka marrë në administrim SIKF. Aktualisht, është duke u përcaktuar bashkëpunimi i mëtejshëm ndërmjet DPT-së dhe AKSHI-t. Për vitin 2024, masat zbutëse do të jenë: (i) Hartimi i

incentivëve efektivë për të mobilizuar pjesëmarrjen e NJQV-ve; (ii) Ofrimi i trajnimeve; (iii) Vazhdimi i takimeve dhe diskutimeve me palët e interesuara; (iv) Komunikimi i reformës dhe rëndësia e saj dhe qartësimi i asaj që nevojitet nga çdo palë e interesuar. Për sa i përket komponentit të menaxhimit të Doganave, për vitin 2024 janë planifikuar masat e mëposhtme për zbutjen e risqeve: (i) vazhdimi i koordinimit në institucion dhe me partnerët; (ii) planifikimi i saktë i buxhetit dhe (iii) fokusi në zbatimin në kohë të procedurave të prokurimit.

Shtylla 4 “Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit”. Risqet kryesore të materializuara për këtë shtyllë lidheshin me: burimet njerëzore (stafi, përgjegjësitë, bashkëpunimi); organizimi i brendshëm (menaxhimi, rolet dhe përgjegjësitë, misionet); komunikimi me palët e interesuara; partnerët e huaj (kompanitë konsulente dhe partnerët/donatorët e huaj. Këto risqe u menaxhuan me sukses nëpërmjet masave të mëposhtme: Rishikimi i prioriteteve dhe planeve operacionale të punës për t'u përshtatur me burimet në dispozicion; Komunikimi i vazhdueshëm për ndërgjegjësimin e vendimmarrësve dhe drejtuesve të njësive publike për rëndësinë e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të SNKSP; Ngritja e kapaciteteve në fushën e zbatimit të SNKSP. Këto masa do të vazhdojnë edhe në periudhën e ardhshme. Gjithashtu, në lidhje me këtë komponent që ka të bëjë me treguesin “Numri shtesë i institucioneve buxhetore të lidhura me SIFQ dhe arkivën elektronike (EA)” për të cilin është përgjegjës Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit, asnjë nga faktorët e riskut nuk është materializuar gjatë vitit 2023. Sa i përket komponentit të Menaxhimit të Borxhit nuk ka risqe të materializuara gjatë vitit 2023.

Shtylla 5 “Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik”. Asnjë risk nuk u identifikua nën komponentin 5.1 dhe komponentin 5.3. Në fushën e auditimit të brendshëm (komponenti 5.2) ka patur vonesa në ndryshimet rregullatore, të cilat kanë bërë të nevojshme përsheptimin e procesit për përgatitjen e procedurave dhe zhvillimin e planeve praktike të veprimit për përmbushjen e afateve. Gjithashtu, sfidat u vunë re në menaxhimin e fondeve të BE-së nën komponentin 5.4, veçanërisht të lidhura me zhvillimin jo të qëndrueshëm të kapaciteteve të burimeve njerëzore, disponueshmërinë e pamjaftueshme të burimeve njerëzore dhe ndryshimet e vonuara ligjore/rregullatore. Me qëllim adresimin e këtyre çështjeve, gjatë vitit 2023 janë ndërmarrë masa si kërkimi i asistencës teknike shtesë për trajnime të mëtejshme dhe riorganizimi i strukturës së burimeve njerëzore dhe shpallja e vendeve vakante në faqen e DAP-it, ndërkohë që paketa e akreditimit ka përfunduar. Për më tepër, gjatë vitit 2024, do të përgatitet dhe zbatohet një plan trajnimi i konsoliduar, i cili do të mbulojë tema dhe metoda të ndryshme të të mësuarit gjatë periudhës 2024-2025, së bashku me zhvillimin e një politike të qëndrueshme të ruajtjes për të siguruar stabilitet dhe efektivitet afatgjatë të burimeve njerëzore.

Shtylla 6 “Mbikëqyrja e Jashtme”. Asnjë risk nuk është materializuar në periudhën raportuese. Përmendet se Komisioni për Ekonominë dhe Financat menaxhoi me kujdes të gjithë procesin e bashkëpunimit me institucionet që kanë ndihmuar në rritjen e nivelit profesional të tij dhe strukturat mbështetëse përkatëse.

Tabela 7: Risqet kryesore të materializuara

Vlerësimi i riskut (probabiliteti dhe ndikimi): L = i Lartë M = i Moderuar U = i Ulët	Faktorët Kryesorë të Risqeve													
	Ndryshime të vonuara ligjore/rregullatore	Siguri mi i pamjaftueshëm financiar	Zhvillimi i paqëndrueshëm i kapaciteteve të burimeve njerëzore	Disponueshmëria e pamjaftueshme të Burimeve Njerëzore	Sfidat e zhvillimit të TI-së ose prokurimit	Disponueshmëria në kohë e AT / mbështetjes	Koordinimi papërshtatshëm							
Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut														
1.1 Programim Makroekonomik i Matur dhe Realist				M										
1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale														
Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent														
2.3 Menaxhimi i Investimeve Publike	M			M										
2.4 Financat Vendore				M										
2.5 Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit														
Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave														
3.1 Menaxhimi i Taksave				L										
3.2 Menaxhimi i Taksës së Pasurisë					L		L							
3.3 Menaxhimi Doganor														
Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit														
4.2 Kontabiliteti				M			U							
4.3 Prokurimi Publik														
4.4 Menaxhimi i Borxhit														
Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik														
5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli														
5.2 Auditimi i Brendshëm	U													
5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit														
5.4 Menaxhimi i Fondeve të BE-së	M		M	M										
Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtme														
6.1 Auditimi i Jashtëm														
6.2 Mbikëqyrja Parlamentare														

5. Kostoja e strategjisë të MFP-së

Më poshtë është një përmbledhje e burimeve të përdorura për zbatimin e reformës gjatë vitit 2023, duke paraqitur të dhënat financiare për shpenzimet gjatë zbatimit të secilës shtyllë të kategorizuar në buxhetin e qeverisë dhe financimin e donatorëve në Euro.

Tabela 8: Burimet e përdorura për zbatimin e Strategjisë së MFP-së²¹

Shtyllat e MFP-së	Shpenzimet faktike 2023			Planifikuar 2023	% e ndryshimit
	PBA	Financimi nga donatorët	Totali 2023		
Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut	-	-	-	-	-
1.1 Programim makroekonomik i matur dhe realist	-	-	-	-	-
1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale	-	-	-	-	-
Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent	-	100 000	100 000	10 000	900%
2.3 Menaxhimi i Investimeve Publike	-	-	-	-	-
2.4 Financat Vendore	-	100 000	100 000	10 000	900%
2.5 Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit	-	-	-	-	-
Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave	104 738	21 415	126 153	1 324 356	-90%
3.1 Menaxhimi i Taksave	-	-	-	-	-
3.2 Menaxhimi i Taksës së Pasurisë	-	18 000	18 000	18 000	0%
3.3 Menaxhimi Doganor	104 738	3 415	108 153	1 306 356	-92%
Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit	-	-	-	-	-
4.2 Kontabiliteti	-	-	-	-	-
4.3 Prokurimi Publik	-	-	-	-	-
4.4 Menaxhimi i Borxhit	-	-	-	-	-
Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	-	6 000	6 000	6 000	0%
5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	-	-	-	-	-
5.2 Auditimi i Brendshëm	-	6 000	6 000	6 000	0%
5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit	-	-	-	-	-
5.4 Menaxhimi i Fondeve të BE-së	-	-	-	-	-
Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtme	-	-	-	-	-
6.1 Auditimi i Jashtëm	-	-	-	-	-
6.2 Mbikëqyrja Parlamentare	-	-	-	-	-
TOTALI	104 738	127 415	232 153	1 340 356	-83%

²¹Ka një ndryshim në totalin e planifikuar për vitin 2023, për shkak të konvertimit të një vlere nga lekë në euro. Ndryshimi është bërë në aktivitetin 3.3.1.1 “Vazhdimi i zhvillimit të një fuqie punëtore më profesionale dhe më të shkathët përmes përmirësimit të praktikave të burimeve njerëzore dhe ofrimit të zhvillimit të kapaciteteve.” nën komponentin 3.3 Menaxhimi i Doganor. Gjithashtu, ka një gabim material në totalin e planifikuar për vitin 2023 në lidhje me Komponentin 2.4 “Financat Vendore”, aktiviteti 2.4.3.1 “Përgatitja e një dokumenti specifik për Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV)”.

6. Përfundimet dhe Rekomandimet

Zbatimi i strategjisë së MFP-së - udhëhequr nga Ministria e Financave - tregon progres të kënaqshëm me pothuajse të gjitha objektivat e vendosura për vitin 2023 të arritura dhe shumicën e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023 në rrugën e duhur ose të përfunduara.

Shtylla 1: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut

Për periudhën në vijim, do të jetë prioritet konsolidimi i rregullave fiskale dhe përmirësimi i mëtejshëm i praktikave të monitorimit dhe raportimit të risqeve fiskale. Në përputhje me Udhërrëfyesin për Qeverisjen e Mirë do të krijohet një këshill fiskal, në vitin 2023 do të përfundohet dokumenti i alternativave për Këshillin Fiskal.

Shtylla 2: Planifikimi i Integruar Strategjik dhe Buxhetor, Monitorimi dhe Raportimi Transparent

Në ndërthurje me objektivat strategjike dhe rekomandimet e BE-së dhe, pas miratimit të bazës së re ligjore për MIP, një fokus i fortë do të mbetet zhvillimi i mëtejshëm i praktikave të MIP në Ministrinë e Financave, SASPAC dhe në veçanti në institucionet buxhetore. Kjo është e nevojshme për të krijuar një NSPP të fortë dhe për të siguruar rolin *gatekeeper* të Ministrisë së Financave. Është i nevojshëm përmirësimi i legjislacionit PPP dhe integrimi i tij i mëtejshëm në sistemet MIP. Në periudhën e ardhshme, fokusi mund të jetë gjithashtu në përmirësimin e proceseve të dokumentacionit dhe monitorimit të buxhetit dhe harmonizimin e sigurt me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Hapja e një sistemi të ri informatik për bashkitë dhe rishikimi i transfertave fiskale ndërqeveritare përbën një bazë të mirë për forcimin e MFP-së në nivel nën kombëtar. Për komponentin e PBA-së, sugjerohet rishikimi dhe përshtatja e afateve kohore të vlerave të synuara siç shprehen në Planin e Veprimit të MFP-së.

Shtylla 3: Menaxhimi dhe Mobilizimi i të Ardhurave

Me synimin e përgjithshëm rritjen e të ardhurave tatimore, rekomandohet të sigurohet përfundimi dhe miratimi në kohë i Strategjisë së re Afatmesme të të Ardhurave, e cila do të informojë vendimmarrësit për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm në përmirësimin e politikave dhe sistemeve të menaxhimit tatimor dhe doganor. Gjithashtu, konsiderohet e rëndësishme që të monitorohet nga afër procesi i reformave të taksës së pasurisë me qëllim përmirësimin e të ardhurave tatimore të bashkive.

Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit

Në lidhje me kontabilitetin, parashikohet një konsolidim i lidhjes dhe përdorimit të SIFQ dhe planifikimi e zbatimi gradual i reformave të kontabilitetit (SNKSP). Sa për prokurimin, fokusi do të mbetet në procedurat më efikase të prokurimit, PPGj, mekanizmat e ankesave dhe përafrimin e ligjit për koncesionet dhe PPP në përputhje me Acquis të BE-së. Zbatimi i Strategjisë së Menaxhimit të Borxhit do të vazhdojë dhe do të zhvillohen instrumente alternative (të gjelbërta) të borxhit. Gjithashtu, rritja e planifikimit të likuiditetit dhe monitorimit të performancës është prioritet për vitin 2024. Do të vazhdojë procesi i përgatitjes së një regjistri gjithëpërfshirës dhe të konsoliduar të aseteve në SIFQ.

Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

Me vendosjen në fuqi të amendimeve të legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, rekomandohet që të fokusohet në zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të metodologjive, mjeteve dhe udhëzimeve dhe të mbështeten institucionet publike për zbatimin adekuat dhe përputhshmërinë me legjislacionin e amenduar. Me qëllim ndjekjen e marrëveshjeve me BE-në, duhet të sigurohet përfundimi në kohë dhe zbatimi i mëpasshëm i Strategjisë Kombëtare Kundër

Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Në fushën e menaxhimit të fondeve të BE-së, forcimi i kapaciteteve institucionale në të gjitha institucionet dhe sigurimi i pajtueshmërisë së plotë me legjislacionin në fuqi për IPA III do të jetë prioritet kryesor për të siguruar asistencë financiare të pandërprerë nga BE-ja.

Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtme

Për forcimin e funksionit të mbikëqyrjes së jashtme, zbatimi i strategjisë së KLSH-së është një prioritet kyç, sikurse është profesionalizimi i mëtejshëm i strukturave mbështetëse të Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat me mbështetjen e jashtme dhe nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet homologe.

Shkurtesat dhe Akronimet

AB	Auditimi i Brendshëm
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AST	Agjencia Suedeze e Taksave
AT	Asistencë Teknike
BE	Bashkimi Evropian
BPGj	Buxheti i Përgjigjshëm Gjnor
DAMS	Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
DFV	Drejtoria e Financave Vendore
DIFP	Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik
DMB	Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit
DMIP	Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike
DPBSh	Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPHKBFP	Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPTP	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
DRF	Deklarata e Risqeve Fiskale
DHAB	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm
DHMFKK	Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
IKD	Instituti Kombëtar Demokratik
IPA	Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KD	Komiteti Drejtues
KEF	Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
KT	Komiteti Teknik
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MF	Ministria e Financave
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MIP	Menaxhimi i Investimeve Publike
MPQM	Mbështetje për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim
MSFQ	Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë
NSH	Ndërmarrje Shtetërore
OEA	Operator Ekonomik i Autorizuar
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm

PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKBZh/UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PQH/OGP	Partneriteti për Qeverisje të Hapur
PPP	Partneritet Publiko-Privat
PZHI	Partnerët për Zhvillim dhe Integrim
QSH	Qeveria e Shqipërisë
RAP	Reforma në Administratën Publike
SAA	Strategjia Afatmesme e të Ardhurave
SELL	Sistemi Evropian i Llogarive
SFQ	Statistikat e Financave të Qeverisë
SIFQSH	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë së Shqipërisë
SISHMF	Sistemi Informatik Shqiptar i Menaxhimit Financiar
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SHPPF	Shpenzimet Publike dhe Përgjegjësia Financiare
SHKKM/AFCOS	Shërbimi i koordinimit kundër mashtrimit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZEKM/OLAF	Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit

Aneksi 1: Statusi i masave të Planit të Veprimit të MFP për 2023

PLANI I VEPRIMIT TË MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE 2023-2026							
Shtylla 1 Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut							Statusi (Zgjidh nga lista e mëposhtme: 1-përfunduar 2-në rrugën e duhur 3-pjesërisht në rrugën e duhur 4-nuk po ecën 5-nuk ka filluar akoma)
Objektivi Specifik (Komponenti) 1.1: Programimi makroekonomik i matur dhe realist							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	PALËT E INTERESIT		
					ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
1.1.1	Parashikim i matur i treguesve makroekonomik në përputhje me parashikuesit e pavarur dhe ndërkombëtar	Krahasimet e vazhdueshme të projeksioneve të treguesve makroekonomik të MF-së me parashikuesit e pavarur dhe ndërkombëtarë dhe publikimi i këtyre krahasimeve çdo vit. Kjo analizë krahasuese do të shpërndahet përmes: "Kuatrit Makroekonomik dhe Fiskal" & "Programit të Reformave Ekonomike".	T1 2023	T4 2026	DPPMF (lider)	FMN	përfunduar
		Adresimi i vendeve të lira të punës për staf të specializuar dhe zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve të specializuara të stafit të DPPM.	T4 2023	T4 2026			pjesërisht në rrugën e duhur
1.1.3	Ruajtja e financave publike të shëndosha përmes pajtueshmërisë së përhershme me Rregullat Fiskale	Garantimi i pajtueshmërisë strikte me rregullat fiskale të mandatuara me ligj. Ky angazhim nënvizon përkushtimin ndaj respektimit të rregullores fiskale të vendosura, nxitjes së një kuadri fiskal elastik dhe forcimit të stabilitetit dhe llogaridhënies së financave publike.	T1 2023	T4 2026	DPPMF (lider)	FMN	përfunduar
		Rritja e transparencës dhe dhënia e shpjegimeve gjithëpërfshirëse në lidhje me respektimin e rregullave fiskale. Ky angazhim do të përmbushet përmes shpërndarjes së rregullt në: "Kuatrin Makroekonomik dhe Fiskal"; "Programin e Reformave Ekonomike"; dhe në "Raportin e Zbatimit të Buxhetit Vjetor, Situata Makroekonomike dhe Fiskale"	T1 2023	T4 2026			përfunduar
Objektivi Specifik (Komponenti) 1.3: Menaxhimi i Risqeve Fiskale							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	PALËT E INTERESIT		
					ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
1.3.2	Prezantimi i Deklaratës vjetore të Risqeve Fiskale dhe zgjerimi gradual i fushës së monitorimit dhe raportimit të risqeve fiskale	Zhvillimi, pilotimi dhe publikimi çdo vit I Deklaratës Vjetore të Riskut Fiskal	T1 2023	T4 2025	DRF	FMN	përfunduar

Shtylla 2: Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent							Statusi (Zgjidh nga lista e mëposhtme: 1-përfunduar 2-në rrugën e duhur 3-pjesërisht në rrugën e duhur 4-nuk po ecën 5-nuk ka filluar akoma)
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.3: Menaxhimi i Investimeve Publike							
					PALËT E INTERESIT		
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
2.3.1	Operacionalizimi i procedurave për përmirësimin e menaxhimit të investimeve publike	Përmirësimi i modulit MIP të SIMFSH-së për të pasqyruar ndryshimet në procedurat e reja MIP (VKM 887).	T1 2023	T4 2024	DMIP (lider), SASPAC, Institucionet Buxhetore	Banka Botërore, FMN, BE	pjesërisht në rrugën e duhur
		Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve për zbatimin e procedurave të MIP-së (VKM 887).	T1 2023	T4 2026	DMIP (lider), SASPAC, Institucionet Buxhetore	Banka Botërore, FMN, BE	në rrugën e duhur
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.4 Financat Vendore							
					PALËT E INTERESIT		
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
2.4.3	Zhvillimi dhe vendosja e Sistemit të ri të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) për përgatitjen dhe monitorimin e buxhetit vendor	Përgatitja e një dokumenti specifik për Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV).	T4 2023	T1 2024	DFV (lider)	SECO	përfunduar
Objektivi Specifik (Komponenti) 2.5 Raportimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit							
					PALËT E INTERESIT		
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
2.5.2	Përmirësimi i monitorimit dhe raportimit për Projektet e Investimeve Publike	Zbatimi i procedurës së monitorimit të MIP-së të miratuar rishazi dhe përmirësimi i procedurave nëse është e nevojshme	T1 2023	T4 2024	DMIP (lider), Institucionet Buxhetore	Banka Botërore	në rrugën e duhur

Shtylla 3: Menaxhimi dhe mobilizimi i të ardhurave							Statusi (Zgjidh nga lista e mëposhtme: 1-përfunduar 2-në rrugën e duhur 3-pjesërisht në rrugën e duhur 4-nuk po ecën 5-nuk ka filluar akoma)
Objekti i Specifik (Komponenti) 3.1 Menaxhimi i taksave							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	PALËT E INTERESIT		
					ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
3.1.2	Rritja e kapaciteteve institucionale për të analizuar dhe zhvilluar politikat tatimore dhe për të menaxhuar reformat tatimore	Zhvillimi dhe zbatimi i ngritjes së kapaciteteve për analizën dhe vlerësimin e politikave tatimore.	T1 2023	T4 2026	DPPT (lider)	FMN	në rrugën e duhur
3.1.3	Zhvillimi dhe zbatimi i iniciativave për të reduktuar hendekun e pajtueshmërisë me TVSH-në	Përmirësimi i qasjeve të menaxhimit të riskut për sektorët e identifikuar si me risk të lartë	T1 2023	T4 2026	DPT (lider)	FMN	në rrugën e duhur
		Përdorimi i sistemit të Fiskalizimit për maksimizimin e të ardhurave nga TVSH-ja	T1 2023	T4 2026	DPT (lider)	FMN	në rrugën e duhur
3.1.4	Zhvillimi dhe zbatimi i një qasjeje të integruar për të reduktuar punën e padeklaruar	Forcimi i dispozitave ligjore për sanksionet për kundërvajtjet që lidhen me punëtorët e padeklaruar dhe nën-deklarimet	T1 2023	T4 2024	MF (lider)	FMN	përfunduar
3.1.5	Sigurimi i taksimit të çdo pasurie të pajustificuar brenda dhe jashtë vendit	Vlerësimi i rasteve të pasurisë së madhe të pashpjegueshme të individëve duke u dhënë inspektorëve kompetencë ligjore për të dhënë vlerësime tatimore nëpërmjet metodave indirekte veçanërisht për individët që nuk marrin pjesë në Programin e Deklarimit Vullnetar	T1 2023	T4 2026	DPT (lider)	FMN	në rrugën e duhur
3.1.6	Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për taksapaguesit	Hartimi dhe zbatimi i një strategjie të ofrimit të shërbimit të tatimpaguesve që synon përmirësimin e produkteve tatimore	T1 2023	T4 2026	DPT (lider)	FMN	pjesërisht në rrugën e duhur
		Përmirësimi i efikasitetit të qendrës kombëtare të thirrjeve me një proces të strukturuar përshkallëzimi për t'u marrë me pyetjet e kompleksiteteve të ndryshme	T1 2023	T4 2026	DPT (lider)	FMN	në rrugën e duhur
		Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të zhvillimit të kapaciteteve për stafin e DPT-së (nga akademja tatimore, universitetet dhe partnerë të tjerë)	T1 2023	T4 2026	DPT (lider)	FMN	pjesërisht në rrugën e duhur
Objekti i Specifik (Komponenti) 3.2 Menaxhimi i taksës së pasurisë							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	PALËT E INTERESIT		
					ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
3.2.1	Përmirësimi i kadastrës fiskale dhe sistemit të mbledhjes së taksës së pasurisë	Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor (aktet ligjore dhe aktet nënligjore) për kadastrën fiskale, taksën mbi tokën dhe pasurinë e paluajtshme dhe aktin nënligjor për vlerësimin e tokës dhe pasurisë.	T1 2023	T4 2025	MF (lider) DPPT (lider)	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), ProTax Albania, dhe Agjencia e Taksave Suedeze (STA)	në rrugën e duhur

Objekti i Specifik (Komponenti) 3.3 Menaxhimi Doganor							
					PALËT E INTERESIT		
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
3.3.1	Modernizimi i proceseve të biznesit dhe menaxhimit të riskut të Administratës Doganore	Vazhdimi i zhvillimit të një fuqie punëtore më profesionale dhe më të shkathët përmes përmirësimit të praktikave të burimeve njerëzore dhe ofrimit të zhvillimit të kapaciteteve.	T1 2023	T4 2026	Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPD (lider), DPD, Koordinator DPD	Delegacioni i BE-së	në rrugën e duhur
		Vazhdimi i investimit në sistemet e TI për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Tarifave (SIMT).	T1 2023	T4 2024		Delegacioni i BE-së	në rrugën e duhur
3.3.2	Zhvillimi i kuadrit të integritetit dhe luftës kundër informalitetit dhe korrupsionit	Zhvillimi dhe zbatimi i një kuadri integriteti.	T4 2023	T4 2026	Drejtoria Antikorrupsion në DPD (lider)		në rrugën e duhur
3.3.3	Rritja e numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar	Vazhdimi i fushatave informuese dhe auditimeve të operatorëve të autorizuar ekonomikë potenciale	T1 2023	T4 2026	Drejtoria e Procedurave në DPD (lider)	Doganat në BE / Jo BE	në rrugën e duhur
3.3.4	Zbatimi i "dritares së vetme kombëtare"	Zhvillimi i konceptit dhe strukturës institucionale të Dritares së Vetme Kombëtare	T1 2023	T4 2026	DPD, Koordinator DPD	Banka Botërore	në rrugën e duhur

Objekti i Specifik (Komponenti) 4.2 Kontabiliteti							
							Statusi (Zgjidh nga lista e mëposhtme: 1-përfunduar 2-në rrugën e duhur 3-pjesërisht në rrugën e duhur 4-nuk po ecën 5-nuk ka filluar akoma)
Shtylla 4: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit							
					PALËT E INTERESIT		
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
4.2.1	Rritja e aksesit dhe përdorimit të SIFQ	Rritja e aksesit të institucioneve buxhetore në modulën e arkivit elektronik të SIFQ.	T1 2023	T4 2024	DPTesari (lider), AKSHI		në rrugën e duhur
Objekti i Specifik (Komponenti) 4.3 Prokurimi Publik							
					PALËT E INTERESIT		
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
4.3.1	Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit	Për përdorimin e kriterit të vlerësimit "Oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto" (MEAT bazuar në kosto)	T1 2023	T4 2024	APP (lider)	SIGMA	në rrugën e duhur
4.3.2	Hartimi dhe zbatimi i prokurimit publik të gjelbër	Përgatitja e metodologjisë për zbatimin e kriterëve të prokurimit të gjelbër/efikasitetit të energjisë.	T1 2023	T4 2023	APP (lider), MIE	Banka Botërore	përfunduar
		Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve mbi prokurimin e gjelbër/efikasitetin e energjisë për profesionistët e prokurimit	T1 2023	T4 2024	APP (lider), MIE	Banka Botërore	në rrugën e duhur
		Rishikimi dhe ndryshimi i kuadrit rregullator (nëse nevojitet).	T1 2023	T4 2026	APP (lider), MIE	Banka Botërore	në rrugën e duhur
Objekti i Specifik (Komponenti) 4.4 Menaxhimi i Borxhit							
					PALËT E INTERESIT		
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
4.4.1	Forcimi i raportimit të menaxhimit të borxhit dhe Marrëdhënieve me Investitorët	Përgatitja dhe publikimi i planit vjetor të huamarrjes.	T1 2023	T4 2023	DPBSH DPPMF	Banka Botërore	përfunduar
		Përgatitja dhe publikimi i Raportit vjetor të Monitorimit të SMB.	T1 2023	T1 2026			përfunduar

Shtylla 5: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik							Statusi (Zgjidh nga lista e mëposhtme: 1-përfunduar 2-në rrugën e duhur 3-pjesërisht në rrugën e duhur 4-nuk po ecën 5-nuk ka filluar akoma)
Objekti i Specifik (Komponenti) 5.1 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli							
PALËT E INTERESIT							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
5.1.1	Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për MFK-në	Rishikimi i ligjit të MFK-së për adresimin e reformave në vazhdim në fushën e MFK-së.	T1 2023	T1 2023	DHMFKK (lider)	BE, SIGMA, SECO	përfunduar
		Rishikimi dhe përditësimi i akteve nënligjore dhe përmirësimi i mëtejshëm i manualit të MFK-së.	T4 2023	T4 2025	DHMFKK (lider)	BE, SIGMA, SECO	në rrugën e duhur
Objekti i Specifik (Komponenti) 5.2 Auditimi i Brendshëm							
PALËT E INTERESIT							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
5.2.1	Vazhdimi i mbikëqyrjes dhe zgjerimi i shërbimeve mbështetëse për institucionet publike dhe ekipet e auditimit të brendshëm	Zhvillimi i mjeteve dhe mekanizmave për kontraktimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm ose krijimi i shërbimeve të përbashkëta të auditimit të brendshëm dhe ofrimi i mbështetjes për institucionet publike që nuk kanë një ekip të auditimit të brendshëm për të përdorur këto mekanizma.	T1 2023	T2 2023	DHAB (lider)	BE, SIGMA	përfunduar
		Përditësimi i ligjit për auditimin e brendshëm për të lehtësuar reformën në fushën e auditimit të brendshëm.	T1 2023	T4 2023	DHAB (lider)	BE, SIGMA	përfunduar
	Profesionalizimi i praktikave thelbësore të auditimit të brendshëm përmes zhvillimit të udhëzimeve dhe ofrimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve	Zhvillimi/përditësimi i Programit të Trajnimit të Trajnerëve mbi Manualin e ri të Auditimit të Brendshëm dhe SGAB	T1 2023	T4 2026	DHAB (lider)	BE, SIGMA	në rrugën e duhur
Objekti i Specifik (Komponenti) 5.3 Inspektimi Financiar Publik dhe Shërbimet e Koordinimit kundër Mashtrimit							
PALËT E INTERESIT							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
5.3.2	Koordinimi i hartimit dhe monitorimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.	Koordinimi i hartimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.	T4 2023	T4 2024	DIFP (lider)	BE, SIGMA	në rrugën e duhur

Objektivi Specifik (Komponenti) 5.4 Menaxhimi i Fondeve të BE-së							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	PALËT E INTERESIT		
					ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
5.4.1	Krijimi i kuadrit ligjor IPA III	Përgatitja dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të BE-së në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit 2021 – 2027 (IPA III).	T1 2023	T4 2023	SASPAC (lider), Zyra Mbështetëse e ZKA, DPFK (CFCU)	DBE	përfunduar
5.4.2	Zhvillimi dhe zbatimi i rregulloreve, procedurave për menaxhimin e IPA III dhe rritja e kapaciteteve të strukturave të IPA III	Miratimi dhe krijimi i strukturave menaxheriale përgjegjëse për zbatimin e IPA III dhe përgatitja e manualeve dhe udhëzimeve për të drejtuar zbatimin e IPA III	T1 2023	T4 2024	Zyra Mbështetëse e ZKA, DPFK (CFCU) SASPAC	DBE	në rrugën e duhur
		Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese të burimeve njerëzore dhe boshllëqeve e aftësive, hartimi i një plani për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, planifikimi i programeve të trajnimit të synuara në përputhje me qëllimet e IPA III dhe nxitja e të mësuarit nga kolegët ndërkombëtar përmes partneriteteve dhe nismave bashkëpunuese.	T1 2023	T4 2026	Zyra Mbështetëse e ZKA, DPFK (CFCU) SASPAC	DBE	në rrugën e duhur
5.4.3	Përmirësimi i procedurave të rregullimit financiar dhe/ose rikuperimit për fondet e BE-së në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare dhe IPA III	Ndërmarrja e një rishikimi gjithëpërfshirës të bazës ligjore kombëtare dhe IPA III, vlerësimi i procedurave ekzistuese të rregullimit financiar dhe rikuperimit dhe identifikimi i dobësive dhe fushave për përmirësim në përputhje me dispozitat ligjore IPA III	T1 2023	T4 2024	DPFK (CFCU) (lider), Zyra Mbështetëse e ZKA	DBE	pjesërisht në rrugën e duhur
		Zhvillimi dhe miratimi i një udhëzuesi gjithëpërfshirës që përshkruan hapat vijues për rregullimet financiare dhe rimëkëmbjen.	T1 2023	T4 2024	DPFK (CFCU) (lider), Zyra Mbështetëse e ZKA	DBE	pjesërisht në rrugën e duhur
		Zhvillimi i moduleve të trajnimit për stafin e përfshirë në ekzekutimin e procedurave.	T1 2023	T4 2025	DPFK (CFCU) (lider), Zyra Mbështetëse e ZKA	DBE	pjesërisht në rrugën e duhur

Shtylla 6: Mbikëqyrja e Jashtëme							
Objektivi Specifik (Komponenti) 6.1 Auditimi I Jashtëm							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	PALËT E INTERESIT		
					ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
6.1.1	Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit metodologjik ligjor, rregullator dhe fleksibël dhe zgjerimi i përdorimit të mjeteve të auditimit	Përcaktimi i ndryshimeve në Ligjin Organik të KLSH-së për të forcur më tej pavarësinë dhe mandatin kushtetues të KLSH.	T4 2023	T4 2024	KLSH (lider)	Izh-ONISA	pjesërisht në rrugën e duhur
6.1.2	Profesionalizimi i raportimit dhe komunikimit në përputhje me strategjinë e komunikimit dhe parimet dhe standardet përkatëse	Të përmirësojë cilësinë e raporteve të auditimit të përshtatur me kërkesat e lexuesve të tij dhe të zgjerojë përdorimin e të gjitha mjeteve të komunikimit për të promovuar vazhdimisht rolin e KLSH-së.	T1 2023	T4 2024	KLSH (lider)		në rrugën e duhur
		Zgjerimi i monitorimit, raportimit dhe komunikimit për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit nga të audituarit.	T1 2023	T4 2026	KLSH (lider)		në rrugën e duhur
Objektivi Specifik (Komponenti) 6.2 Mbikëqyrja Parlamentare							
Nr	MASA	AKTIVITETI	FILLIMI	MBARIMI	PALËT E INTERESIT		
					ENTITETI PËRGJEGJËS	PARTNERËT	
6.2.1	Profesionalizimi i mëtejshëm i strukturave mbështetëse të Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat	Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe shkëmbimeve me kolegët ndërkombëtarë me parlamentet dhe Komisionet e tyre të Llogarive Publike në BE dhe rajon.	T4 2023	T4 2024	Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat	Instituti Kombëtar Demokratik, Fondacioni Westminster, DBE.	në rrugën e duhur